



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

**ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM**  
**KOMUNA E PODUJEVËS**  
**(ZKKK)**

*Raporti i Punës per vitin 2023*

*Podujevë, janar 2024*

## **Zyra Komonale për Komunitete dhe Kthim – ZKKK**

**ZKKK**- Koordinon të gjitha punët me të gjitha Drejtoritë Komonale, Kuvendin Komunal dhe trupat e tij: Komiteti për Buxhet dhe Financa, Komiteti për Komunitete, Zyra për të Drejtat e Njeriut, Njësi për Barazi Gjinore, për Integritim Evropian, Zyrën për Informim. Poashtu ZKKK ka bashkëpunim edhe me Institucionet e Sigurisë: Policia e Kosovës (PK), KFOR-in, FSK-në dhe Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi.

-Bashkëpunim me nivelin qendror që kanë përgjegjësi të drejtpërdrejta apo të tërthorta për Çështjen e Komuniteteve jo-shumicë; Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK), Zyra e Kryeministrit – Zyra për Çështje të Komuniteteve jo-shumicë, Zyra e Presidentit/es për Komunitetet jo-shumicë, Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale (MPMS), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), Ministria e Financave (MF) dhe ministritë tjera shtetërore.

### **- Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë:**

**ZKKK** - Bashkëpunon edhe me Organizatat Ndërkombëtare: Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE), Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM), Komisioni i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR), Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS), Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara (UNDP), Agjensioni për Zhvillim Ndërkombëtar i SHBA-së (USAID), Caritas Zvicrran, URA 2 si dhe Organizata Joqeveritare vendore si: OJQ – Organizata e komuniteteve jo-shumicë “Qendrimi”, “Shpresa Demokratike” dhe “Në hap me ne” në Podujevë etj.

## **ZKKK Aktivitetet**

### **• ZKKK në bashkëpunim me Drejtorinë për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik**

Në koordinim edhe me Zyrën për Informim ka përcjellur informata që kanë ardhur nga Zyra për Çështje të Komuniteteve/Zyra e Kryeministrit. Njoftimin lidhur me thirrjen publike për financim të bizneseve që kanë për qëllim ngritjen e nivelit të punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë, ku përmes Zyrës për Informim dhe përmes Facebook-ut njëkohësisht ka informuar edhe komunitetet jo-shumicë përmes përfaqësuesve të tyre dhe kryesuesit të Komitetit për Komunitete. Bizneset mund të aplikojnë me projekte të cilat kanë për synim punësimin dhe regjenerimin e të hyrave të komuniteteve jo-shumicë.

- Aktivitetet që kanë të bëjnë me punësim të qëndrueshëm brenda komuniteteve jo-shumicë me theks të veçantë tek gratë, të rinjtë, me aftësi të veçanta si dhe grupe tjera të marginalizuara.
- Aktivitetet që kanë të bëjnë me organizmin e trajnimeve me të cilat do të nxisin, zhvillojnë dhe ndërtojnë kapacitetet e stafit të komuniteteve jo-shumicë të bizneseve, në

mënyrë që ata të pajisen me njohuritë e nevojshme për të qenë të aftë për zhvillimin e veprimtarisë së biznesit.

- Aktivitetet që synojnë ngritjen e kualitetit të jetesës të pjesëtarëve më të rrezikuar të komuniteteve jo-shumicë.
- Aktivitetet për zhvillimin e mundësive për komunitetet jo-shumicë, aftësimi i tyre në gjenerizimin e të hyrave.
- ZKKK i inkurajon komunitetet jo-shumicë që të konkurojnë në këto projekte biznesore në përputhje me thirrjen publike nga Zyra për Çështje të Komuniteteve/Zyra e Kryeministrit. Ne si ZKKK në bashkëpunim me Drejtorinë për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik iu kemi dhënë të gjitha informatat për konkurim të projekteve biznesore dhe kemi shprehë gatishmërinë t'iu ndihmojmë në rregullimin e dokumentacionit.
- Bizneset në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë në fushat prioritare në vijim:
  - Rritja e kapaciteteve të bizneseve e cila do të krijojë vende të reja të punës për pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë.
  - Ndihmë financiare që ndikon në rritjen e kapaciteteve prodhuese të bizneseve nën pronësinë e komuniteteve jo-shumicë.
  - Ndihmë financiare që ndikon në ngritjen e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve që ndikojnë në përfitimet shtesë në biznese nën pronësim të komuniteteve jo-shumicë.
  - Trajnim i stafit prej komuniteteve jo-shumicë.
  - Blerja e pajisjeve apo mjeteve të punës për bizneset nën pronësinë e komuniteteve jo-shumicë etj.

### **Aktivitet:**

ZKKK-ja takim pune me përfaqësuesit e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE-ja). Tema ishte Siguria në Bashkësi e cila lidhet me çështjen e personave që janë të kthyer prej vendeve të konflikteve, luftërave të ndryshme ku kanë të bëjnë me ekstremizmin fetar, ideologjik, racor, etnik etj, ku ne si institucione shtetërore dhe lokale dhe mekanizmat që merren me këto çështje në bashkëpunim edhe me organizatat ndërkombëtare çdo herë i kemi parasysh këto fenomene që të merremi me këta persona për stabilizimin socio-ekonomik dhe integrimin e tyre në të gjitha sferat e jetës si edhe në aspektin psikologjik që të kemi edhe trajnime shtesë që këta persona të inkorporohen në jetën dhe shoqërinë kosovare, që mos të ndikojnë në shtrirjen e frymëzimeve e ideologjive të gabuara në shoqërinë tonë.

**Aktivitet:**

ZKKK-ja takim pune me zyrtarët e Qendrës për Punë Sociale (QPS) ku tema e diskutimit ishte për informimin për gjendjen ekonomiko-sociale dhe familjeve që janë në asistencë sociale, ku në bazë të të dhënave zyrtare nga zyrtari që merret me të dhëna në kuadër të QPS-së u informuam për të gjitha komunitetet dhe familjet që marrin asistencë sociale. Komuniteti me shumicë, familjet që janë në asistencë sociale janë 887 familje me 4037 anëtarë, ndërsa komunitetet tjera jo-shumicë që janë në asistencë sociale, komuniteti ashkali janë 66 familje me 353 anëtarë, komuniteti rom janë 5 familje me 37 anëtarë ku nga këto dy komunitete janë 71 familje me 390 anëtarë, ndërsa në total komuniteti shumicë dhe jo-shumicë janë 887 familje me 4037 anëtarë. Këto ishin të dhëna zyrtare nga zyrtari i QPS-së që merret me statistika.

**Aktivitet:**

ZKKK-ja takim pune me Entin e Punësimit ku si temë bisedimi ishin të dhënat nga Enti i Punësimit edhe për Personat e Riatdhesuar që zyrtari për Integrimet Evropiane në kuadër të ZKKK-së iu ndihmon të gjithë personave të riatdhesuar për kompletimin e dokumentacioneve që ata lajmërohen në Entin e Punësimit dhe i marrin informacionet shtesë për trajnimin e profesioneve të tyre në projekte të ndryshme biznesore ku edhe mbajnë trajnime shtesë për aftësitë e tyre profesionale dhe certifikohen për ato biznese dhe pastaj konkurrojnë me projekte dhe marrin grante mjete pune për vetëpunësim dhe ku kanë mundësi edhe të punësojnë edhe të tjerë dhe të rrisin biznesin për të hyrat dhe regjenerim të mjeteve financiare. Këta persona financohen prej UNDP-së (Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim) dhe në dokumentacionin shtesë për hapjen e biznesit iu ndihmon Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik.

- Poashtu u informuam nga Enti i Punësimit për personat që lajmërohen për punë nga komunitetet jo-shumicë ku numri ndryshon dhe në bazë të variacioneve dhe statistikave të lajmëruar nga komunitetet jo-shumicë ishin 31 persona të të dy gjinive që janë të interesuar të gjejnë punë si në sektorin publik ose privat. Çdo herë ne i përcjellim informatat dhe jemi në kontakt me kompanitë që kërkojnë punëtorë si psh: në ndërtimtari, gastronomi, bujqësi etj.

**Aktivitet:**

ZKKK-ja takim pune me KFOR-in dhe përfaqësuesin e Policisë së Kosovës (Njësiti për Siguri në Bashkësi), ku u vlerësua situata e sigurisë në komunën tonë, bashkëpunimi me qytetarët, me përfaqësuesit e komuniteteve, nëpërmjet ndërtimit të Partneritetit dhe

Institucioneve të Përbashkëta Lokale, për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me Sigurinë në Bashkësi edhe me komunitetet jo-shumicë.

Në Komunën tonë u vlerësua që gjendja e sigurisë është stabile dhe e qetë.

**Aktivitet:**

ZKKK-ja takim pune me Caritasin Zvicrran me temën “Veprimi i Komunave për Ri-integrim dhe Diasporë”. Tema ishte në lidhje me sfidat dhe nevojat për grumbullimin e të dhënave nga institucionet përkatëse të Qeverisjes Lokale që merren me riatdhesimin dhe ri-integrimin e personave të riatdhesuar. Gjithashtu, u diskutua për fushat që mund të kontribuojnë, për personat e riatdhesuar. Fusha këto si: Arsimi, Shërbimet Financiare, Emigracioni dhe Refugjatët, PPP (Partneriteti Publiko-Privat) dhe Zhvillimi, Rekrutimi dhe Seleksionimi, fusha e IT-së, e Komunikimit, Barazisë Gjinore, me qëllim të koordinimit më të mirë në interes të përbashkët institucional për ri-integrimin e personave të riatdhesuar.

**Aktivitet:**

ZKKK-ja në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Kompaninë e Ujësjellësit kemi vizituar lagjen “Ali Ajeti” dhe kërkesa e banorëve ka qenë nevoja për shtrirjen e rrjetit të ri të ujësjellësit në rrugën “Ulqini”. Arsyet janë që rrjeti i vjetër nuk i furnizon mjaftueshëm komunitetet jo-shumicë me ujë të pijes sepse është rritur edhe numri i shtëpive e paralelisht me këtë janë rritur edhe kërkesat për një projekt të tillë. Duke parë gjendjen faktike me inxhinierë përkatës është paraparë se ka nevojë për një rrjet të ri të ujësjellësit që të shtohen kapacitetet e ujit të pijes që ndikon shumë pozitivisht në mirëqenien dhe jetën e tyre. Për këto tri projekte, duke falënderuar edhe Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Kompaninë e Ujësjellësit janë bërë paramasat dhe parallogaria e tyre. Ne si ZKKK do të mundohemi që në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse dhe me Zyrën për Çështje të Komuniteteve brenda Zyrës së Kryeministrit, do t'i shtyjmë përpara këto projekte në mënyrë që të realizohen në mënyrën më të mirë të mundshme.

**Aktivitet:**

Pas disa takimeve që patëm me Zyrën për Çështje të Komuniteteve brenda Zyrës së Kryeministrit, me ZKKK-të e Komunave, Komuna jonë paraqiti edhe praktikat e mira si në infrastrukturë dhe në të gjitha fushat e jetës. Komuna jonë ishte shembull për bashkëjetesë të qytetëruar me të gjitha komunitetet, me theks të veçantë u diskutuan edhe

praktikat e mira nëpër Komuna për Integrimin dhe Stabilizimin e komuniteteve jo-shumicë si dhe avancimin e mëtutjeshëm të institucioneve qendrore dhe lokale në përmirësimin e kushteve si në infrastrukturë, ambient, arsim, shëndetësi etj, për një zhvillim ekonomik dhe mirëqenie sociale.

- Zyra për Çështje të Komuniteteve brenda Zyrës së Kryeministrit, shprehu gatishmërinë për bashkëpunimin dhe përkrahjen financiare edhe me ndonjë donatorë të mundshëm, me projekte infrastrukturale për të mirën e komuniteteve jo-shumicë. ZKKK-ja në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse; Drejtorinë e Urbanizmit, Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit i kemi identifikuar dhe i kemi plotësuar formularët e dërguar me të dhënat në lidhje me tri projektet. Pastaj të njëjtat, të nënshkruara nga Kryetari i Komunës dhe të protokolluara i kemi dërguar tek Zyra për Çështje të Komuniteteve brenda Zyrës së Kryeministrit. Këto projekte ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien e komuniteteve jo-shumicë; ndërtimi i një rruge, ndërtimi i një trotuari dhe ndërtimi i rrjetit të ri të ujësjellësit. Në aplikacionet apo formularët e plotësuar u paraqitën edhe arsyet faktografike që këto projekte ndikojnë shumë pozitivisht te komunitetet jo-shumicë, të cilat poashtu u mirëpritën për angazhimin dhe qasjen e Komunës tonë.

#### **Aktivitet:**

Paraprakisht falenderojmë Organizatën Ndërkombëtare për Migrim – IOM për përkrahjen e vazhdueshme që i kanë dhënë komunës tonë si dhe bashkëpunimin në realizimin e shumë projekteve përmes programeve të ndryshme të bashkëpunimit të EU-CSP III. Njëherit Komuna e Podujevës në bashkëfinancim mbështeti edhe dy projekte në dy shkolla fillore:

- SHFMU “Zahir Pajaziti” Orllan me furnizimin me pajisje teknologjike (pajisje përcjellëse të cilat i takojnë teknologjisë informative).
- Në shkollën FMU “Ali Ajeti”, Sfeqël furnizimi me vegla, mjete për kabinetin e lëndës muzikore dhe pajisje tjera.

Këto projekte kanë rëndësi të veçanta sepse aty mësojnë nxënësit e komuniteteve jo shumicë dhe janë në interes të të gjithë nxënësve. Komuna do të kontribuojë për bashkëfinancimin e këtyre projekteve.

Komuna, DKA-ja iu premtojnë se do të angazhohen maksimalisht në mirëmbajtjen e këtyre projekteve pas implementimit, ku vazhdon bashkëpunimi dhe përkrahja!

ZKKK-ja në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare për Migrim (IOM-in) në bazë të Memorandumit të Mirëkuptimit me Komunën tonë po vazhdon me implementimin e projekteve për Stabilizimin e komuniteteve jo-shumicë me projekte të cilat financohen nga BE në participim me Komunën ku edhe menaxhohen nga Zyra e BE-së në Kosovë.

**Aktivitet:**

ZKKK-ja me IOM-in vizitua dy shkolla në Komunën tonë, shkolla këto në të cilat vijojnë mësimin edhe nxënësit e komuniteteve jo-shumicë.

\* Vizitë në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët SHFMU “ALI AJETI” në Sfeqël dhe SHFMU “ZAHIR PAJAZITI” në fshatin Orllan.

Ne u informuam për projektet e mundshme që bashkëfinancohen nga BE dhe Komuna e që janë shumë në interes të avancimit mësimor, në teknologjinë e avancuar si në kabinete të lëndëve shkencore, kulturore, arti, sporti etj. Të gjitha këto u mirëpritën mirë nga stafi i shkollës dhe bashkëbiseduesëve për projektet që mund të përfitonin me një shumë deri në 15000€.

\* Ne kërkuam që t'i shqyrtojnë kërkesat e tyre, ku mund të financohet në projektet që janë në dobi dhe interes të personelit arsimor e me theks të veçantë për arritjen e nxënësve në avancim të mëtutjeshëm për mësim nxënie si në aspektin teorik dhe praktik ku u vlerësua lartë nga personeli arsimor nga dy shkollat që mësojnë edhe nxënësit e komuniteteve jo-shumicë si në:

SHFMU “ALI AJETI” Sfeqël, dhe  
SHFMU “ZAHIR PAJAZITI” Orllan.

\* Në vizitën e radhës që do ta bëjmë ZKKK-ja me Zyrtaren e IOM-it do t'i shohim kërkesat e këtyre dy shkollave për mundësitë e realizimit të projekteve.

**Aktivitet:**

ZKKK-ja në koordinimin dhe bashkëpunim me Komitetin për Komunitete, me përfaqësuesin e Komitetit për Komunitete z. Xhafer Ademi bëme një kërkesë nga Fondacioni Amaneti që t'i ndihmojë me pako ushqimore dhe higjienike 175 familje të komuniteteve jo-shumicë, pasi që po afrohet Muaji i Shenjtë i Ramazanit. Këto familje nuk kanë mundësi që t'i përballojnë shpenzimet që nevojiten për këtë muaj.

\* Është më se e nevojshme përkrahja për këto familje pasi që nuk kanë të ardhura të rregullta mujore, madje shumica edhe nuk janë përfitues të skemës sociale dhe jetojnë në gjendje jo të mirë ekonomike. Kjo ndihmë me pako ushqimore dhe higjienike do të ndihmojë këto familje që Muaji i Shenjtë i Ramazanit të përballohen më lehtë.

\* Do të jemi mirënjohës si gjithëherë për ndihmën e ofruar nga të gjithë donatorët e mundshëm për të gjitha familjet në nevojë.

## **Aktivitet:**

Në mbledhjen e Komitetit për Komunitete temat ishin:

\* Informatë nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale rreth gjendjes socio-ekonomike dhe çështja e banimit – strehimit për komunitetet jo-shumicë.

\* Gjatë muajve janar, shkurt dhe mars 2023, DSHMS-ja ka ndihmuar 4 familje të komuniteteve jo-shumicë me mjete financiare në vlerë prej 1400€ nga mjetet vetanake, ndërsa rastet tjera të cilat kanë aplikuar për subvencione për barna janë në shqyrtim e sipër.

\* Në bashkëpunim me donatorët janë ndihmuar 31 familje me pako ushqimore dhe higjienike, 2 familje me dru për ngrohje dhe një familje me stufë.

\* Rastet tjera që kanë pasë kërkesa për veshmbathje janë drejtuar tek Kryqi i Kuq – Podujevë.

\* Sa i përket çështjes së banimit, strehimit në vazhdimësi kemi kërkesa për ndërtim të shtëpive, strehim apo për përmirësimin e kushteve të banimit, për renovimin e shtëpive, për mbështetje me material ndërtimor për pajisje sanitare, për mobilje etj, për komunitetet jo-shumicë për të cilët ndihma është e nevojshme.

\* Gjithashtu, në mungesë të pronës, nuk kemi pasë mundësi të përfshihen shumë kërkesa për ndërtim. Rastet të cilat janë me shumë prioritet për banim janë identifikuar dhe jemi në pritje edhe nga donatorët.

\* ZKKK-ja në bazë të thirrjes publike nga Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK) e cila ka për qëllim t'i ndihmojë pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë për çështjen e banimit, ndërtim të shtëpive, renovim etj. ZKKK i ka ndihmuar në rregullimin e dokumentacioneve për secilën kërkesë, që ka ndikim të drejtpërdrejtë në mirëqenien e qytetarëve, komuniteteve jo-shumicë.

\* Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim paraqiti “Raportin e Punës për Vitin 2022” në Mbledhjen e Komitetit për Komunitete të Kuvendit të Komunës së Podujevës.

## **Aktivitet:**

ZKKK-ja në bazë të programit për Decentralizimin dhe Mbështetjen e Komunave (DEMOS) ku për bazë ka mbështetjen e MAPL-së në Kosovë në realizimin e një studimi



që analizon strukturat dhe funksionet komunale, që kanë mandat pune me grupet e marginalizuara. Më specifikisht ky studim analizon:

- \* Kapacitetet e Zyrave Komunale për Komunitete dhe Kthim
- \* Funksionet e zyrtarëve komunal për të drejtat e njeriut
- \* Funksionet e zyrtarëve për barazi gjinore, të drejtat e fëmijëve dhe zyrtarëve të tjerë komunal përgjegjës për të drejtat dhe shërbimet për grupet e marginalizuara.

- Ky studim përfshin të gjitha komunat e Kosovës dhe realizohet në përputhje me Planin Strategjik dhe Operacional të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Qëllimi specifik ishte promovimi i të drejtave të njeriut në nivel lokal me theks të veçantë në grupet e marginalizuara
- Theks të veçantë kishte edhe rishikimi funksional i zyrave, departamenteve dhe drejtorive dhe ZKKK-ve për komunitete dhe të drejtat e njeriut.

ZKKK i paraqiti të gjitha të dhënat që i posedon në databazë për grupet e marginalizuara e sidomos për komunitetet jo shumicë në komunën tonë.

Komuna jonë ka hartuar:

-Planin e Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas 2023-2026.

Në komunën tonë jetojnë 163 familje, shtëpi banimi të komuniteteve jo shumicë me gjithsej 935 banorë.

1. Komuniteti Ashkali dominon me 152 familje me 857 anëtarë,
2. Komuniteti Rom 9 familje me 67 anëtarë,
3. Komuniteti Egjiptas 3 familje me 11 anëtarë.

Nga këto familje, në bazë të të dhënave nga QPS, me asistencë sociale janë 71 familje. Prej tyre, 71 familje nga komuniteti ashkali me 353 anëtarë dhe 5 familje nga komuniteti rom me 37 anëtarë, gjithsej 390 anëtarë.

❖ **Arsim:**

- Në shkollat fillore në komunën tonë mësimin e vijnë 179 nxënës
- Në shkollat e mesme të larta mësimin e vijnë 16 nxënës, gjithsej 195 nxënës.
- Në studime universitare 3 studentë.

- ❖ ZKKK bashkëpunon ngushtë edhe me Organizata Ndërkombëtare për të iu ndihmuar në Stabilizimin Ekonomik të Komuniteteve jo shumicë. Vlen të ceket se në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit të Komunës me Zyrën e BE-së përmes IOM-it janë realizuar shumë projekte të bizneseve familjare për vetëpunësim të komuniteteve jo shumicë. Ka edhe një familje prej Komunitetit Ashkali ka përfituar mjete pune.

- ❖ Sfidë mbetet punësimi, ku për bazë merret edhe niveli i shkollimit që kohëve të fundit është në rritje niveli arsimor.
- ❖ Çështja e strehimit, banimit është problem në vete. Çështja pronësore te këto komunitete është më e ndërlikuar, të cilët nuk kanë pronë të mjaftueshme. Gjithashtu, edhe çështja e legalizimit të pronave ende nuk është definuar. Dihet se këto komunitete jetojnë në gjendje më të rëndë socio-ekonomike, por komuna i ka çdoherë parasysh këto familje të iu dalë në ndihmë edhe përmes donatorëve tjerë.  
Komuna çdoherë është angazhuar t’iu ndihmojë grupeve të marginalizuara me theks të veçantë komuniteteve jo shumicë në krijimin e kushteve për jetë. Komuna ka bërë maksimumin e mundshëm për të arritur integrimin e tyre në shoqëri dhe fushat tjera, siç janë: arsimi, shëndetësia, punësimi, banimi, mirëqenia sociale, infrastruktura, media, kultura, rinia, sporti, stabilizimi ekonomik etj.  
Mirëpo akoma mbetet për të punuar në këtë drejtim, sepse nevojat dhe kërkesat e tyre në aspektin e punësimit, strehimit, gjendjes socio-ekonomike janë të mëdha.

### **Aktivitet:**

Pjesëmarrja në Modulin e III-të të trajnimit “Legjislacioni dhe politikat lidhur me Arsimin Gjithëpërfshirës”.

Temat:

- Kapacitetet për Arsimin Gjithëpërfshirës

Aftësitë – pjesëmarrja efektive (e të gjithëve duke përfshirë edhe përfituesit, nxënësit), bashkëpunimi (përfshirë aftësitë për zgjedhjen e konflikteve) dhe komunikimi (përfshirë aftësinë e të dëgjuarit, vëzhgimit, ndjeshmërisë, fleksibilitetit dhe përshtatshmërisë, aftësi shumëgjuhësore.

- ❖ Synimet e Strategjisë të Kosovës në fushën e arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës.
- ❖ Sigurimi në praktikë i këtyre synimeve.
- ❖ Komuna jonë ka hartuar Planin e Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas 2023-2026. Disa nga para-fushat që trajtohen në këtë Plan të Veprimit:
  1. Arsimi, shëndetësia, punësimi, mirëqenia sociale, banimi, infrastruktura, mediat, kultura, rinia e sporti.
- ❖ ZKKK-ja diskutoi dhe paraqiti Planin e Zbatimit në fushën e arsimit:
  - Qëllimi: Ndërtimi i sistemit arsimor cilësor dhe gjithëpërfshirës të bazuar në drejtësi, barazi dhe respekt për diversitetin që i kontribuon integrimin të plotë të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas në shoqëri.
- ❖ Tema ishte: Motivimi për pjesëmarrje të shtuar në arsim. Veprimet: Organizimi i fushatës së ndërgjegjësimit për prindër për regjistrimin me kohë të fëmijëve në shkollë.
- ❖ Masat për mosrespektim të Ligjit mbi shkollimin e obliguar. Veprimi: Identifikohen nxënësit që kanë braktisur shkollën dhe që nuk vijnë në shkollën rregullisht.

- ❖ Organizohen takime informative me komunitete në lidhje me detyrimet ligjore mbi arsimin e obliguar.
- ❖ Veprim: Ndërmerren masa ligjore ndaj stafit të shkollës që nuk raporton me kohë, rastet e braktisjes dhe mosvijueshmërisë.
- ❖ Veprim: Identifikohen nxënësit që nuk kanë vijuar shkollën.
- ❖ Veprim: Organizohen takime me grupet e identifikuara me qëllim të informimit për mundësitë lidhur me zhdukjen e analfabetizmit.

### **Aktivitet:**

Seminar tre ditorë në Hotel Magra Austria – Bogë me temën: “Projekti – Veprimi i Komunave për Riintegrim dhe Diasporë – MARDI, i cili implementohet nga Caritasi Zvicran në Kosovë – CACH – në bashkëpunim me Departamentin për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve (DRPR – IH) dhe me angazhimin e Pro Cosulting Service. Punëtorja është mbajtur me Përfaqësuesit Komunal siç janë: ZKKK, QPS dhe Zyrat e Punësimit dhe qëllimi i punëtorisë ka qenë:

Hartimi i Planit të Veprimit Komunal për Riintegrim 2023-2025.

Plani i Veprimit përmban objektivat, aktivitetet konkrete dhe masat për arritjen e objektivave, përcakton institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për arritjen e secilit objektiv, saktëson kornizën kohore për realizimin e secilit aktivitet, koston e përafërt financiare për zhvillimin e aktiviteteve, indikatorët matës të objektivave dhe aktiviteteve dhe mjetet e verifikimit.

\* Strategjia si dokument qeveritar i politikave të riintegrimit është obligativ të zbatohet në tërë territorin e Republikës së Kosovës në kuadër të Planit të Veprimit të Strategjisë është paraparë edhe Hartimi i Planit Komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe Integrimin e Personave të Huaj Azilkërkues.

Me qëllim të zbatimit të koordinuar në praktikë të Strategjisë së Riintegrimit:

ZKKK-ja në bashkëpunim me drejtoritë komunale si dhe në koordinim me Departamentin e Riintegrimit për Personat e Riatdhesuar dhe personat e huaj (DRPR – IH) në kuadër të MPB-së si dhe përfaqësuesit e organizatave vendore e ndërkombëtare të hartohet Plani i Veprimit Komunal për Riintegrim dhe integrimin e të huajve për komunën tonë.

\* ZKK-ja ka hartuar “Planin Komunal” për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar në Komunën e Podujevës 2019-2022.

\* Tani do të formohet Grupi Punues për hartimin e Planit Komunal për Riintegrim të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e personave të huaj për vitet 2023-2025 për Komunën e Podujevës.

\* Plani i Veprimit ka për qëllim riintegrimin e qëndrueshëm socio-ekonomik të personave të riatdhesuar dhe integrimin e personave të huaj përmes avancimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të një sistemi efektiv e efikas të shërbimeve të fokusuar në nevojat e tyre.

**Aktivitet:**

ZKKK-ja në koordinim me Komitetin për Komunitete në bashkëpunim edhe me drejtorin e BPZHR, ku temë ishte: Shqyrtimi i mundësive për sigurimin e lëndëve djegëse, për ngrohje për sezonin e dimrit për familjet në nevojë që janë në gjendje të rëndë socio-ekonomike, me theks të veçantë për komunitetet jo-shumicë.

ZKKK-ja paraqiti gjendjen e rëndë ekonomike të gjitha familjeve që kanë nevojë për t'i ndihmuar pa dallim etnie që gjenden në gjendje jo të mirë ekonomike. ZKKK-ja paraqiti të dhënat statistikore për gjendjen socio-ekonomike të familjeve në bazë të QPS-së për vitin 2023, struktura nacionale në SNS – Nacionaliteti:

Shqiptarë 887 familje me 4037 anëtarë,

Komuniteti Ashkali 71 familje me 390 anëtarë,

Komuniteti Rom 5 familje me 37 anëtarë. Duke u bazuar në këto të dhëna, ZKKK-ja kërkoi të gjitha mundësitë dhe bazat ligjore për t'iu ndihmuar këtyre familjeve, nga komuna ose ndonjë donatorë eventuale, nëpërmjet BPZHR-së.

- Pas paraqitjeve të këtyre argumenteve, ZKKK-ja në Komitet për Komunitete dhe debateve të anëtarëve të këtij komuniteti, zyrtarët e BPZHR-së na informuan për të gjitha mundësitë dhe proceset ligjore për çështjen e pyjeve dhe furnizimit duke e ditë që kompetent për drunjtë, lëndët djegëse të konfiskuara është Agjensioni i pyjeve dhe këto forma shkojnë përmes tenderimit publik që është e rregulluar me ligj ku mund të dalin në ankand publik dhe ndonjë donatorë i mundshëm me vullnet të mirë dhe me participim, mund të dalë në ndihmë këtyre familjeve në nevojë.

**Aktivitet:**

Takim me KFOR-in ku diskutuam për disa çështje me rëndësi për komunën tonë, si gjendja e sigurisë, lëvizja e lirë, integrimi i komuniteteve jo-shumicë, çështjet pronësore, procesi i kthimit të qëndrueshëm, riintegrimi i personave të riatdhesuar, Hartimi i Planit Komunal për Personat e Riatdhesuar dhe Personave të Huaj – Azil Kërkues, e shumë tema tjera në interes të qytetarëve ku u vlerësua poashtu se gjendja e sigurisë në komunën tonë është e qetë dhe stabile.

**Aktivitet:**

Trajnim në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim (MKK) me temën “Përdorimi i databazës së re të të dhënave në përputhje me Rregulloren (QRK) nr.01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur (PZH) dhe Zgjidhje të Qëndrueshme ku është themeluar Komisioni Komunal për Kthim të Qëndrueshëm prej 7 anëtarëve që janë zyrtarë komunal. ZKKK-ja është kryesuese dhe përfshihen dy anëtarë tjerë nga MKK-ja dhe tjetri nga UNHCR-ja.

Caktimi i dy zyrtarëve përgjegjës për qasje dhe regjistrimin e aplikacioneve në bazën e të dhënave të MKK-së që të kemi bashkëpunim të linjave qendrore dhe lokale lidhur me kërkesat e PZH (personave të zhvendosur) për kthimin e tyre në vendin e origjinës që t'i

kemi të gjitha të dhënat e sakta në bashkëpunim me MKK-në, UNHCR-në dhe ZKKK-në. Qasja në Sistemin e Menaxhimit të Rasteve (Bazën e të Dhënave të Ministrisë për Komunitet dhe Kthim) është e kufizuar dhe është vetëm për përdorim zyrtar. Nuk mund të përdori, të përshtatni, riprodhojë, dublifikojë, lëshojë, përkthej, modifikojë, transmetojë, shpërndajë apo shfaqë asnjë informacion të marrë nga baza e të dhënave, përveç kur lejohet me ligj dhe për kryerjen e detyrave zyrtare. Informatat që gjinden në bazën e të dhënave të Ministrisë për Komunitet dhe Kthim dhe përdorimi i saj është i mbrojtur nga legjislacioni përkatës në fuqi i cekur në preambulën e kësaj deklartare. Keqpërdorimi i informacionit në përmbajtje këtu ose të bazës së të dhënave do të rezultojë në procedurë disiplinore dhe/ose penale.

### **Aktivitet:**

ZKKK-ja në Koordinim me DKA-në dhe OJQ-në “Voice of Roma (Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve), përmes organizimit të mësimi intenziv, plotësues për nxënësit e komuniteteve jo-shumicë në ato shkolla fillore ku vijojnë mësimet. Ky program është mbështetur nga Komuna – DKA –ja me personel arsimor nga komunitetet jo-shumicë ku janë financuar nga OJQ-ja “Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve”, ku ekziston edhe një memorandum i nënshkruar prej Organizatës dhe Komunës. ZKKK-ja në koordinim me DKA-në ishim në komunën e Vushtrisë në bashkëkoordinim me OSBE-në për zgjidhjen e çështjes së pagesave për personelin arsimor nga komunitetet jo-shumicë në mënyrë që të gjendet forma dhe zgjedhja e mundësisë të pagesave të personelit arsimor “Tutorët” që të parashihet për të ardhmen që të kenë kod financiar për pagesën e tyre nga MPL-ja dhe MF.

### **Aktivitet:**

Punëtori për zyrtarët komunalë për Komunitete dhe Kthim dhe nga DSHMS – QPS. Kjo punëtori ishte e organizuar nga Caritasi Zvicran në Kosovë në “Hotel Magra Austria”, Bogë. Tema ishte: Plani i Veprimit Komunal për Riintegrim 2023-2025 për Personat e Riatdhesuar dhe Azilkërkues të Huaj. Trajnerë ishin profesorë nga Institui i Psikologjisë – Universiteti i Prishtinës. Agjenda përmbante tema të tilla si:

- Identiteti shoqëror dhe kulturor (shoku kulturor, identiteti shoqëror dhe kulturor)
- Çrregullimet potenciale të përjetuara nga refugjatët (çrregullimet e përshtatjes, çrregullimi i ankthit dhe panikut, çrregullimi i depresionit)
- Qasja efektive në integrimin e azil-kërkuesve dhe refugjatëve (qasja holistike për integrimin e azil-kërkuesve dhe refugjatëve, ndihma e parë psikologjike)
- Baza ligjore për refugjatë, të riatdhesuar, azilkërkues (njohja e klientit, çasja me klientin, traumat e veçanta)
- Njohja e individëve dhe familjeve të riatdhesuara (çfarë nevoja kanë, bisedë jo vetëm me kryefamiljarin por me të gjithë anëtarët, vlerësimi i nevojave)
- Baza ligjore (Kodi nr 06/ L-006 Kodi i Drejtësisë për të Mitur, Ligji Nr. 02/ L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe Ligjin Nr. 04/ L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/ L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare etj).
- Teoria e Bronfenbrenner’s: sistemi bioekologjik dhe migrimi,
- Teoria e Aeron Anthonovskit: SOC,
- Akulturimi: identiteti kulturor etj.

### **Sektori i strehimit:**

Sektori i strehimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian është problematik dhe i pa përmbushur sipas dëshirës dhe vullnetit tonë, por ka disa sfida të cilat e pengojnë këtë, si p.sh: mungesa e pronave, pronat e pa legalizuara tek ata të cilët i posedojnë ato, mungesa e nje banese kolektive etj, me ç'rast donatorët nuk arrijnë t'i ndihmojnë, poashtu edhe komuna dhe institucionet qendrore. Komuna ka investuar në ndërtimin dhe meremetimin e disa shtëpive të cilat kanë poseduar pronë, poashtu edhe Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit dhe Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit.

- Gjatë vitit 2023 ka pasur kërkesa të ndryshme për strehim dhe riparim të shtëpive të komunitetit RAE. 1 familje e cila ka banuar në banesa të improvizuara në Stacionin e Trenit, është strehuar në shtëpi në Lagje të Dëshmorëve. ZKKK-ja në bashkëpunim me IOM-in, duke e ditur gjendjen e rëndë socio-ekonomike, kësaj familje i kemi ndihmuar me mjete pune me shumë 2900€ për biznes farkatarë pa participim nga ana e familjes.
- Dy familje janë ndihmuar me kulme nga materiali i shkollës Shaban Shala dhe ambulancës.
- 1 familje është ndihmuar me një shporet dhe serrë për bujqësi.
- Me Shoqatën “Jetimat e Ballkanit” i kemi vizituar disa familje që kanë kërkuar ndërtim të shtëpisë, por në pamundësi të pronës nuk kemi pasur mundësi t'iu ndihmojmë.
- Si plan për strehim planifikojmë strehimin e disa familjeve që janë raste sociale nga komunitetet në Lagjen e ndërtuar nga Fondacioni Shqiptarët për Shqiptarët – Elvis Naçi edhe familjet që janë në gjendje të rëndë socio-ekonomike nga komunitetet jo-shumicë.

### **Aktivitet:**

Nga mbledhja e Komitetit për Komunitete u shqyrtua dhe u miratua “Plani i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023”. Në këtë plan pune parashihen shumë aktivitete pune dhe vizita në vendbanimet ku jetojnë komunitetet jo-shumicë në mënyrë që të njoftohemi për gjendjen socio-ekonomike, punësimin, arsimimin, banimin, strehimin, infrastrukturën etj.

\* Gjithashtu parashihet të kemi edhe informata të përhershme, ZKKK-ja në koordinim dhe bashkëpunim me Komitetin për Komunitete ku do të vlerësohen edhe vizitat nëpër lagje dhe shkolla ku ka nxënës të komuniteteve jo-shumicë.

\* Do të bëjmë identifikimin e nxënësve të komuniteteve jo-shumicë të cilët eventualisht e kanë ndërprerë shkollimin dhe të angazhohemi në bashkëpunim me DKA-në për përfshirjen e tyre në procesin mësimor.

\* Identifikimi i personave të komunitetit jo-shumicë të cilët e kanë ndërprerë shkollimin e mesëm dhe ndërmarrja e veprimeve për përfshirjen e tyre në procesin mësimor joformal për përfundimin e klasave përkatëse.

\* Do të bëhet analizë e realizimit të Planit të Punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2023 çdo gjashtë muaj.

\* ZKKK-ja do të ketë informata çdo herë ku do të mbikëqyrë në mënyrë të drejtpërdrejtë në realizimin e plotë të drejtave, lirive dhe interesave të bashkësive etnike që jetojnë në territorin e Komunës së Podujevës.

\* ZKKK-ja në koordinim me Komitetin për Komunitete çdoherë i shqyrton të gjitha kërkesat dhe ankesat që i drejtohen ZKKK-së dhe Komitetit për Komunitete.

### **Aktivitet:**

Me kërkesën e Komitetit për Komunitete ZKKK-ja dhe anëtarët e komuniteteve, përfaqësues të komuniteteve jo-shumicë kishim takim pune me drejtorin e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, për shqyrtimin e mundësive për mjete financiare për shënimin e 15 shkurtit “Dita e Flamurit të Ashkalive”.

### **Aktivitet:**

ZKKK-ja në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare për Migrim (IOM) po vazhdon me implementimin e projekteve për stabilizimin e komuniteteve jo-shumicë në komunën tonë. Projekto këto të cilat i financon BE-ja dhe menagjohen nga Zyra e BE-së në Kosovë. Ky program ofron asistencë financiare dhe teknike për fillimin e bizneseve të vogla apo zgjerim të atyre ekzistuese sidomos të atyre bizneseve që promovojnë dhe forcojnë stabilizimin ekonomik të qëndrueshëm për komunitetet jo-shumicë. Po ashtu financohen edhe projekte të tjera si në arsim, kulturë, ambient etj ku ka pjesëmarrës të komuniteteve jo-shumicë.

- ZKKK- ja në bashkëpunim me Menagjeren e Projekteve nga IOM-i patëm takim me drejtorin e DKA-së, ku tema ishte që të bashkëpunojmë dhe t’i vazhdojmë projektet në arsim, në ato shkolla ku mësojnë nxënësit e komuniteteve jo-shumicë për kabinete, teknologji, informatikë, rregullim të ambientit, fusha sportive etj, në bashkëpunim financiar me komunën për avancimin e mëtutjeshëm në fushën e arsimit ku DKA-ja e falënderoi IOM-in për të gjitha projektet e deritashme dhe vazhdimin e projekteve të reja për bashkëfinancim.

### **Aktivitet:**

ZKKK-ja në bashkëpunim me zyrtaren e IOM-it kishim takim edhe me drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit. Tema ishte për vërshimet e fundit në komunën tonë dhe mundësinë për të ndihmuar. Drejtori i paraqiti dëmet që janë shkaktuar nga këto vërshime në bazë të Komisionit të Vlerësimit në teren ku janë prekur më se 145 familje në ekonomi familjare, pastaj dëme në bujqësi, në infrastrukturë etj. Dëmet kapin shifrën mbi 2 milion €. Është e pamundur që komuna t’i kompensojë e vetme këto dëme pasi dihet që kemi një buxhet të limituar ku kërkohet nga Qeveria dhe donatorët tjerë të na ndihmojnë për sanimin e këtyre dëmeve dhe kompenzimin e shumë familjeve që kanë pësuar në ekonominë familjare.

Po ashtu edhe disa familje të komuniteteve jo-shumicë në lagjen “Xhafer Meta” kanë pësuar dëme në ekonomi familjare ku ne do të mundohemi me mundësitë tona t’iu dalim në ndihmë. Komuna nuk ka ndonjë fond të madh për çështje emergjente, donacionet janë shumë të mirëseardhura për ne, mbetemi me shpresë në ndihmën tuaj.

### **Aktivitet:**

ZKKK në bazë të thirrjeve publike nga Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK) e cila ka për qëllim që t’i ndihmojë pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë në Republikën e Kosovës të

cilët janë në gjendje të rëndë socio-ekonomike. Ata duhet të konkurojnë dhe t'i plotësojnë aplikacionet. Duke u bazuar në këto thirrje publike, ZKKK i ka ndihmuar në rregullimin e dokumentacioneve për secilën kërkesë. Projektet ishin me rëndësi të veçantë dhe ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve të komuniteteve jo-shumicë:

1. Për ndërtimin e shtëpive
2. Për renovimin e shtëpive, banesave
3. Për mbështetje me material ndërtimor
4. Për subvencionimin e projekteve dhe aktiviteteve që promovojnë të drejtat e komuniteteve jo-shumicë dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës
5. Për ndarjen e pakove ushqimore, higjienike për pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë për të cilat ndihma është e nevojshme.
6. Për ndarjen e mobileve për pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë për të cilët ndihma është e nevojshme.

ZKKK-ja ka kontaktuar me përfaqësuesit e komuniteteve jo-shumicë për realizimin e këtyre projekteve i kemi ndihmuar edhe në rregullimin e dokumentacionit për dorëzim në MKK ku parashihen kriteret e dokumentacionit:

1. Aplikacionin/Kërkesen të plotësuar më të gjitha të dhënat dhe të nënshkruar nga ana e aplikuesit;
2. Kopjen e Letërnjoftimit për aplikuesin dhe anëtarët e tjerë të moshës madhore të familjes;
3. Certifikatën e lindjes për anëtarët e mitur të familjes;
4. Deklaratën mbi bashkësinë familjare;
5. Deklaratën nën betim që nuk ka përfituar më parë ndihmë ndonjë projekt nga MKK;
6. Dëshminë që është në asistencë sociale;
7. Dëshminë mbi të ardhurat mujore nën pagën mesatare;
8. Dokumentet tjera mbi gjendjen shëndetësore të aplikuesit apo anëtarëve tjerë të familjes.

Informata plotësuese

Prioritet në kushte të barabarta duhet të kenë kategoritë si në vijim:

1. Përfituesit potencialë me familjar në nevoja të veqanta;
2. Përfituesit potencialë me familjar në gjendje të rëndë shëndetësore;
3. Përfituesit potencialë me fëmijë nën moshën 5 vjeçare;
4. Përfituesit potencialë pa të ardhura apo të cilët përfitojnë nga skema e asistencës sociale;
5. Përfituesit potencialë me paaftësi mentale apo fizike;
6. Prinderit vetë ushqyes.

ZKKK-ja ka bërë thirrje edhe në Komitetin për Komunitete për aplikim dhe iu kemi ndihmuar në rregullimin e dokumentacionit dhe ata janë shumë falenderues për sqarimet, informimin dhe ndihmën tonë. ZKKK çdoherë ka qenë, është dhe do të jetë në shërbim të qytetarëve me shumë respekt për komunitetet jo-shumicë.

### **Aktivitet:**

ZKKK pati takim pune me zyrtarët e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kosovë, ku temë e diskutimit ishte roli i Komitetit Komunal Veprues në komunën tonë.



\* Komiteti Komunal Veprues angazhohet dhe vepron në zbatimin e aktiviteteve komunale në kuadër të Strategjisë dhe Planit Komunal të Veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shoqërinë kosovare dhe rolin që do të ketë në komunën tonë për stabilizimin e komuniteteve jo-shumicë ku do të shërbejë si strukturë mbështetëse lokale për koordinimin e aktiviteteve me Zyrën e Kryeministrit për Qeverisje të Mirë në kuadër të procesit të zbatimit dhe monitorimit të strategjisë.

Fushat të cilat do të trajtohen në Planin e Veprimit për Integrimin e Komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën tonë që janë me rëndësi të veçantë për një shoqëri më të avancuar për angazhime dhe punë të mëtutjeshme në shërbim të qytetarëve, në arsim, shëndetësi dhe mirëqenie sociale, punësim, banim, infrastrukturë, media, kulturë, rini, sport, pjesëmarrje dhe përfaqësim të komuniteteve jo-shumicë.

Në Komitetin Komunal Veprues janë edhe dy anëtarë të komuniteteve jo-shumicë që përfaqësojnë drejtpërdrejt interesat e komuniteteve jo-shumicë përmes dy OJQ-ve vendore në Komunën e Podujevës: OJQ-ja “Qendrimi” komuniteti ashkali dhe OJQ-ja “Në hap me ne” komuniteti ashkali. Këto organizata bashkëpunojnë dhe bashkëveprojnë me strukturat qeverisëse lokale dhe me ZKKK-në dhe në fokus kanë nxitjen e nevojave imediate nga komunitetet jo-shumicë.

#### **Aktivitet:**

ZKKK-ja me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE-në) pati temë diskutimi edhe dokumentet e rëndësishme për vetëqeverisjen lokale që do të angazhohet Komiteti Komunal Veprues për Strategjinë dhe Planin e Veprimit kundër dhunës në familje, Plani i Punës për barazi dhe diskriminim, Plani Lokal i Veprimit për Integrimin e Komuniteteve RAE si dhe për Planin Lokal të Veprimit për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe të Huajve (Azil kërkuesëve) në Komunën e Podujevës.

#### **Aktivitet:**

ZKKK në koordinim me OSBE-në kishim një trajnim me anëtarët e Komitetit Komunal të Veprimit në Mitrovicë, ku pjesëmarrës ishin edhe komunat tjera si: Mitrovica, Vushtrria, Skenderaj. Tema ishte Zbatimi i Strategjisë Nacionale për Integrimin e Komuniteteve jo-shumicë dhe në bazë të kësaj strategjie 2022-2026 në çdo komunë të prodhohen dokumentet shtesë për avancimin dhe zbatimin e strategjisë. Sipas specifikave të komunave ku jetojnë dhe veprojnë komunitetet jo-shumicë komunat e kanë obligim ligjor në hartimin e dokumenteve për Vetëqeverisjen Lokale të harmonizuara me dokumentet dhe strategjitë nacionale që merren me Integrimin e komuniteteve jo-shumicë që janë:

1. Strategjia dhe Plani i Veprimit kundër dhunës në familje
2. Plani i Veprimit për barazi dhe diskriminim
3. Plani lokal i Veprimit për Integrimin e Komuniteteve RAE
4. Plani i Veprimit për Riintegrimin e të Riatdhesuarve dhe të Huajve (Azil kërkuesit)

\* Komuna jonë në këtë trajnim ka dhënë kontribut ku u vlerësua edhe nga trajnerët e

trajnimin për Integrimin dhe Stabilizimin socio-ekonomik të komuniteteve jo-shumicë.

\*Duke u bazuar në Strategjinë Nacionale për Integrimin e komuniteteve jo-shumicë dhe prodhimin e dokumenteve bazë për qeverisje lokale në fushat e rëndësishme të Planit të Veprimit Komunal për Integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali, Egjiptian në komunën tonë, ZKKK-ja në koordinimin të mirë me të gjitha drejtoritë komunale, vlerësohet si komuna më e mirë për shërbime dhe ndihmë për të gjithë qytetarët e me theks të veçantë për komunitetet jo-shumicë.

\* Plani i Veprimit Komunal për Integrimin dhe Stabilizimin e Komuniteteve jo-shumicë fokusohet në shtyllat kryesore siç janë: arsimi, shëndetësia, punësimi, mirëqenia sociale, banimi, infrastruktura, mediat, kultura, rinia dhe sporti.

\* ZKKK-ja ka bashkëpunim edhe me Organizatat Jo Qeveritare (OJQ-të) si ato ndërkombëtare dhe vendore që merren me Integrimin dhe Stabilizimin e komuniteteve jo-shumicë.

OJQ-të vendore janë aktive dhe shumë bashkëpunuese me Qeverisjen Lokale dhe ZKKK-në siç janë: OJQ “Qendrimi”, OJQ “Në hap me ne” dhe OJQ “Shpresa Demokratike”.

### **Aktivitet:**

Veprimi i Komunave për Riintegrim dhe Diasporë – MARDI

-Trajnimi për Implementimin e Udhëzuesit për Qasjen e të Huajve në Aftësim Profesional dhe Punësim.

Temat:

\*Korniza ligjore dhe të drejtat e të huajve

\* Rregullorja për Integrimin e të huajve në Kosovë Kategoritë përfituese të integrimit

\*Rregullorja për integrimin e të huajve në Kosovë- masat specifike të integrimit

\* Korniza e kualifikimit dhe arsimimi i vazhdueshëm profesional

\*Rregullorja për Integrimin e të huajve në Kosovë – institucionet përgjegjëse për menaxhimin koordinimin dhe monitorimin e procesit të integrimit:

### **GRUPET E AZIL KËRKUESVE**

\*Religjioz (racor), etnik, fetar, grupi politik dhe Grupi Social i Veçantë

\*Personat me status të refugjatit dhe personat me status të mbrojtjes plotësuse, gëzojnë të drejtat si në vijim:

1.Për qëndrim në Republikën e Kosovës për kohën sa zgjat statusi i refugjatit dhe mbrojtjes plotësuse

2.Ndihmë sociale elementare

3. Strehim elementar

4. Kujdes shëndetësor

5. Arsimit

\*Aplikuesit për mbrojtje ndërkombëtare

6. Te ketë arsimim për aplikuesit e fëmijëve
7. Të ketë lirinë e mendimit dhe besimit fetar
8. Punësim dhe aftësim profesional për realizimin e të drejtave të aplikuesve për mbrojtjen ndërkombëtare përkujdeset DSHAM, respektivisht qendra e Azilit.

### **Aktivitet:**

Detyrimet e të huajve sipas kategorive

1. Aplikuesi për mbrojtje ndërkombëtare
2. I huaji me leje qëndrimi të përkohshëm, dhe me leje qëndrimi të përhershëm është i detyruar të i përmbahet legjislacionit të zbatueshëm në Republikën e Kosovës
3. Personit të cilit i është njohur statusi i personit pa shtetësi është i detyruar të respektoj kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore të Republikës së Kosovës si dhe masat e ndërmarra për mbrojtjen e rednit publik
4. Të gjitha kategorive të të huajve nuk u lejohet themelimi i partive politike por të formojë asociacione në pajtim me legjislacionin në fuqi

\* Të Drejtat e të Huajëve me leje qëndrimi të përhershëm janë:

1. Punësim dhe vetë- punësim
2. Aftësim profesional
3. Arsim
4. Mirëqenie sociale, pension dhe sigurim shëndetësor
5. Qasje më të mira dhe shërbime
6. Ndihmë juridike falas
7. Të drejtat në asocim apo antarsim në një organizat që përfaqëson punëtor apo punëdhënësit ose në ndonjë organizat tjetër, antarët e të cilës janë të përfshirë në një, profesion specifik, duke përfshirë përfitimet që rrjedhin nga ato organizata

### Masat specifike të Integrit

Vlerësimin e nevojave, kurset e gjuhës, kurset për integrim, akomodimi etj.

\* Pajisja me dokumentacion përkatës

MPB/DSHAM përkujdeset që në afatin sa ma të shkurtër të mundshëm kohor t'i pajisë të huajt, me dokumente për leje të qëndrimit, dokumentet e udhëtimit, si parakusht për qasjen e tyre në procesin e integrit.

\* Kategoritë përfituse të integrit

1. Aplikuesit për mbrojtje ndërkombëtare
2. Personat me status refugjati
3. Personat me Mbrojtje Plotësuse
4. Personat me Mbrojtje të Përkohshme
5. Personi me status të personit pa shtetësi
6. Personi me Qëndrim të përhershëm

7. Familjarët e përfituesit të kategorive të kërkuara në rast të bashkimit familjar.

**Aktivitet:**

Me ftesë të MAPL ishim në takime informuese, që ishte edhe thirrje Publike

-Për ndërtimin e shtëpive për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë në komuna për të cilët ndihma është e nevojshme.

-Në takim ishim SHZKKK\_DSHMS sektori i strehimit, banimit dhe Kryesuesi i asamblesë.

-ZKKK-ja dhe DSHMS sektori i strehimit patëm takime me përfaqësuesit e komuniteteve që udhëheqin OJQ-të për komunitete jo shumicë ku i informuam për këto dy projekte të rëndësishme:

-Ndërtimin e shtëpive

-Renovimin e shtëpive, ku edhe iu shpërndamë aplikacionet për të konkuruar, dhe u shprehëm të gatshëm t'iu ndihmojmë edhe në plotësimin e aplikacioneve.

-Afati kohor për aplikim është deri më 12.05.2023.

**Aktivitet:**

-Takim pune me DRC Këshilli Danez për refugjatë ku tema ishte për stimulimin dhe ndihmën e nxënësve të komuniteteve jo shumicë për shkollimin në SHML (Shkollat e Mesme të Larta-Profesionale)

-Që çdo nxënës të ketë ndihmë vjetore prej 150 euro dhe pagesa e një shujte ditore prej 2 deri në 3 euro.

-Për këtë iniciativë ne patëm takime ZKKK-ja dhe DRC edhe me Drejtorinë e Arsimit ku i informuam, ku e mirëpritim këtë angazhim dhe e falenderojmë DRC-në.

**Aktivitet:**

Takim pune me anëtarët e Komitetit Komunal Veprues, komuna e Podujevës:

Tema ishte Hartimi i Planit të Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Podujevës 2023-2026

Ku parashihen një sërë aktivitetesh që do të zbatohen në nivel komunal për zbatimin e këtij plani në avansimin e të drejtave të komuniteteve jo shumicë.

Fushat të cilat trajtohen në këtë plan të veprimit janë: Arsimi, Shëndetësia, Punësimi, Mirëqenia Sociale, Banimi, Infrastruktura, Mediat, Kultura, Rinia, Sporti dhe Diskriminimi.

**Aktivitet:**

Zyra për Çështje të Komuniteteve pranë Kryeministrit, ku morëm pjesë edhe ZKKK ja Komuna e Podujevës.

Tema: Koordinimi i ZQK së me zyrtarët komunal për Komunitete dhe Kthim, dhe për OJQ të që punojnë dhe veprojnë me komitetet jo shumicë në Kosovë.

Diskutuaam për disa iniciativa të Qeverisë për punësim dhe praktika me pagesë, të cilat do të jenë me interes të veçantë për komunitetet pakicë dhe koordinim të punëve me nivelin komunal dhe Qendror, për të ju krijuar mundësi punësimi komuniteteve jo shumicë, për një stabilizim ekonomik, që do të ndikojnë në mirëqenien socio ekonomike për komunitetet pakicë.

Në takim pati prezantime dhe programe konkrete, për mundësitë për platformën praktike me pagesë që ofrohet në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, punës dhe transfereve.

-Krijim i lidhjeve mes OJQ-ve dhe për OJQ-të me zyrtarët komunal për komunitete dhe kthim për identifikimin dhe mundësitë e punësimit për komunitetet pakicë.

ZKKK-ja komuna e Podujevës, në bazë të diskutimeve për punësimin dhe praktika me pagesë:

Rekomanduaam:

Që të ndërmerren masa nga Komuna për zhvillimin e projekteve për aftësimin profesional të pjesëtarëve nga komunitetet jo shumicë në fushat dhe profesionet që ka nevojë tregu i punës: Punësim në firmat private, ku ka kërkesa për punëtorë, kjo do të jetë forma më e mira për zbutjen e papunësisë, me programin publiko-privat.

#### **Aktivitet:**

Në bazë të thirrjes publike prej Ministrisë së Administratës së Pushtetit Lokal: Për renovimin e shtëpive dhe banesave për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë në Komunën tonë, dhe ndërtimin e shtëpive për këto komunitete.

ZKKK-ja në bashkëpunim me DSHMS sektori për strehim (banim) iu kemi ndihmuar në rregullimin e dokumentacionit për aplikim në MAPL  
Ku prej tyre për ndërtim të shtëpive ishin 6 kërkesa që posedojnë pronë për konkurim dhe 93 kërkesa për renovim të shtëpive.

#### **Aktivitet:**

Duke iu referuar dokumenteve që ishin në rend të ditës pika 8 dhe 9 , ZKKK-ja isha prezent në Komitetin për politikë dhe buxhet dhe financa për diskutim, që është edhe diskutim publik.

Plani komunal për Riintegrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në komunën e Podujevës 2023-2025 dhe

Plani i veprimit për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Podujevës 2023-2026.

## **Vizitat në të gjitha lagjet ku jetojnë komunitetet jo-shumicë: Rom, Ashkali, Egjiptian në Komunën e Podujevës**

**Shefi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim  
Udhëheqësi i Njësitit për të Drejtat e Njeriut  
Zyrtari për të Drejtat e Fëmijëve**

Konform detyrave dhe aktiviteteve që na është dhënë nga Kryetari i Komunës javë më parë komunitetet Ashkali, Rom dhe Egjiptian që jetojnë në komunën tonë për gjendjen e tyre ekonomiko-sociale, numrin e fëmive në tërësi, numrin e fëmijëve që janë të përfshirë në shkollimin parafillorë, fillor dhe të mesëm, gjendjen e infrastrukturës në tërësi si dhe kushtet e jetës së këtyre komuniteteve.

1. Vizitë në komunitetin ashkali në fshatin Orllan ku jetojnë dhe banojnë 7 shtëpi të komunitetit ashkali me 44 anëtarë, ku u informuam prej banorëve për jetën e tyre, si për arsim, punësim, mirqenie sociale, banim infrastrukturor etj.

Gjithësejt janë 8 nxënës ku prej tyre 5 janë vajza dhe 3 janë djem, gjatësia e udhëtimit për këta nxënës nga lagjja deri në shkollë është 1km e 400 m, ne si grup për të marrë këto shënime faktike ishim edhe në Shkollën “Zahri Pajaziti” në fshatin Orllan.

Infrastruktura te këto komunitete është e rregulluar nga Komuna, problem për këta është çështja e punësimit por është një fenomen te këto familje dhe nëse ju ofrohet ndonjë punë e rregullt hezitojnë të lirohen prej asistencës sociale ku më shumë preferojnë të punojnë punë sezonale që ta kenë edhe ndihmën sociale ku janë të liruar edhe prej shërbimeve tjera publike, për këtë arsye te ky komunitet është më e shprehur rritja e natalitetit edhe martesat e hershme .

2. Vizita në komunitetin ashkali në fshatin Batllavë, u informuam drejtpërdrejt nga banorët e këtij komuniteti për jetën e tyre si për arsim, punësim, mirqenie sociale, banim, infrastrukturë etj.

Në këtë lagje jetojnë 13 shtëpi familje të komunitetit ashkali me gjithësejt 63 anëtarë  
Ndihmë sociale marim 6 familje me 34 anëtarë

Nga ky komunitet në shkollën SHFMU “Luigj Gurakuqi” në fshatin Batllavë mësimin e vijojnë 8 nxënës ku prej tyre janë 5 djemë dhe 3 vajza

Brenga dhe problem kryesor i këtyre është punësimi dhe përmisimi i gjendjes së tyre ekonomike Shkolla është afër diku 300m, kërkesa e tyre është për ndërtimin e trotuarit prej lagjeve në shkollë ky projekt veq është i parapare nga Drejtoria e Shërbimeve Publike që do të realizohet këtë vit

3. Vizita në komunitetin ashkali në fshatin Sfeqël, jetojnë dhe banojnë 3 familje të komunitetit ashkali me 13 anëtarë

Ndihmë sociale merr një familje

Infrastruktura rrugore këta banorë e kanë të zgjedhur plotësisht, largësia nga shtëpitë deri SHFMU “ Ali Ajeti” është 1km e 200 m

Në SHFMU “ Ali Ajeti” në fshatin Sfeqël vijojn mësimin 5 nxënës

Pra 3 djem dhe 2 vajza

Edhe në Sfeqël ishim në vizitë në SHFMU “ Ali Ajeti”

Vlenë të theksojmë se gjatë këtyre vizitave kemi bërë edhe fotografi nga këto komunitete por gjatë javës së ardhshme na mbesin që t’i vizitojmë edhe dy vendbanime të këtyre komuniteteve në Podujevë përkatësisht në rrugën Ali Ajeti si dhe në rrugën Xhafer Meta.

### **Vizita në lagjen “Ali Ajeti”-në qytet Podujeva 3**

Në këtë lagje jetojnë dhe banojnë komunitetet jo shumicë si vijon

1. Komuniteti Ashkali 71 familje me shtëpi 388 banor
2. Komuniteti Rom 9 shtëpi me 67 banor
3. Komuniteti Egjiptian 2 shtëpi me 11 banor

Gjithësej janë 88 shtëpi, familje me 462 anëtar

Në këtë lagje për këtë vizitë pune na shoqëroi edhe kryesuesi i komunitetit për komunitete z.Xhafer Ademi, njëherit edhe kryetar i OJQ-së Qëndrimi, nga radhët e komuniteti ashkali.

Në këto vizita u informuam drejtpërdrejt nga banorët e këtyre komuniteteve për jetën dhe sfidat e tyre të përditshme si për banimin, punësimin, arsimin, shëndetësin dhe mirëqenien sociale, infrastruktura, shërbimet publike dhe gjendjen socio-ekonomike.

Nxënësit e këtyre komuniteteve mësimet i vijojnë në shkollat SHFMU” Shaban Shala”-

Podujevë në këtë shkollë kemi 8 nxënës nga grupi parafillor, 2 janë vajza dhe 6 janë meshkuj nga klasa e I deri në klasën e IX, në SHFMU “ Naim Fashëri “ – Podujevë nga komunitetet jo shumicë mësimet i vijojnë 78 nxënës, prej tyre janë 43 djem dhe 35 vajza.

Gjatësia e udhëtimit që bëjnë nxënësit e këtyre komuniteteve nga shtëpia deri në shkollë është 1 kilometër e 400 metra.

Infrastruktura është rregulluar bashkë me trotuare si dhe ndriqimi.

### **Banimi dhe Infrastruktura**

Sa i përket banimit ka kërkesa për ndërtim të shtëpive por problem kryesor te këto komunitete është se nuk posedojnë prona palujtshme të legalizuara në emër të tyre, ku disa familje jetojnë në gjendje të rëndë socio-ekonomike dhe në bashkësi familjare që banimi si plotëson kushtet për jetë.

Dy familje që jetojnë në gjendje jo të mirë socio-ekonomike këta posedojnë edhe dokumentacionin që kanë pronë për ndërtim të shtëpive.

1. Një familje te lagjia “Ali Ajeti”-Podujevë rruga Ulqini nga komuniteti ashkali jeton në gjendje të rëndë ekonomike me 8 anëtar të familjes, shtëpia në gjendje mjaft e rëndë për banim, ky ka pronë në emër të vet dhe ka shumë nevojë për ndërtim të shtëpisë.

2. Dy familje nga komuniteti ashkali jetojnë në bashkësi familjare me 9 anëtarë të familjes me gjendje të rëndë ekonomike, pronën e kanë në emër të tyre si dhe kanë hapësirë për ndërtim të shtëpisë.

Disa Familje kanë shumë nevojë për renovimin e shtëpive si në sanitari, rregullimin e banjove, dyshemeve, çative, në dyer e dritare etj.

Dy familje jetojnë me qira nuk kanë as pronë as shtëpi janë të ardhur nga lagjet tjera në lagjen “Ali Ajeti”

Problemi kryesor është punësimi, këta mundësinë e shohin vetëm punësimin sezonal te kompanitë private, këta edhe me siguri ndonjë punë të përhershme hezitojnë të punojnë sepse i gëzojnë disa benifite që lirohen prej disa shërbimeve publike pa pagesë, por është e theksuar te këto komunitete nataliteti, lindja e fëmijëve për të realizuar skemat sociale si dhe shtesat që kanë për lehona

Infrastruktura është rregulluar mirë në rrugë, trotuare, rrjeti i kanalizimit, rrjeti i ujësjellësit, rrjeti i ndriqimit në vazhdimësi janë dy kërkesa të këtyre lagjeve

1. Ndërtimi i rrejtit të ri për ujësjellës në rrugën e ulqinit që është bërë edhe projekti nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe kompanisë së ujësjellësit,
2. Po ashtu ishte kërkesa për rrjetin e ndriqimit në rrugën “Lagjia e Parë” ku jeton komuniteti rom me 9 shtëpi me 67 anëtar, kjo rrugë ka gjatësi prej 110 metra.

Këto dy projekte do të ndikojnë në mirëqenien dhe kushtet të jetës më të mirë të këtyre komuniteteve jo-shumicë

Në lagjen Ali Ajeti në rrugën Ulqini në një pronë private është krijuar një deponi ilegale e mbeturinave, ku e vërshtirëson jetën e këtyre banorëve dhe është kërkesë e tyre që të largohet

**Në SHFMU “ Naim Fashëri” –Podujevë vijojnë mësimin këta nxënës** Gjithësejt Janë 78 prej tyre 35 vajza, 43 djem, disa prej tyre në numër të vogël mungojnë shumë në shkollë.

**Në SHFMU” Shaban Shala” – Podujevë vijojnë mësimin total 8 nxënës nga komunitetet REA**

Nga grupi parafillorë janë dy vajza

Klasa e I një nxënës

Klasa e II dy vajza

Klasa e V një vajzë edhe një djalë

Klasa e VII një djalë

**Në shkollën e Mesme “Fan S Noli” vijonë mësimin 2 nxënës**

**Në Shkollën e Mesme “ Isa Boletini” vijojnë mësimin 14 nxënës, njeri prej tyre nuk e vijon mësimin për arsye personale.**

**Në Rrugën “Ali Ajeti”- Podujevë**

Gjithësejt 71 familje me 388 anëtarë.



## **Lagjia “Ali Ajeti” komuniteti egjiptian me 11 anëtar**

**Komuniteti rom në lagjen “Ali Ajeti” jetojnë dhe banojnë 9 shëpi me 67 anëtar**

## **Vizit punë në lagjen e komunitetit ashkali në rrugën “Xhafer Meta”-Podujeva 2**

Në këtë lagje banojnë 51 familje shtëpi të komunitetit ashkali me 318 banorë

**Fëmit e këti komuniteti nxënsit e vijojn shkollimin në SHFMU “Dr Ibrahim Rugova”, distancën e shkollës nga shtëpa e kanë 980 metra,**

**Nxënësit e komunitetit ashkali nga lagjia “Xhafer Meta” që vijojnë shkollimin në SHFMU “Dr Ibrahim Rugova”,  
Gjithësejt janë 72 nxënës 36 janë femra dhe 36 meshkuj.**

Në këtë vizitë pune ishte i pranishëm edhe Fitim Sejdiu përfaqësues i komunitetit ashkali dhe kryetar i OJQ- Në Hap me Ne, dhe anëtar i Komunitetit Komunal Veprues.

U informuam dhe pamë nga afër për jetën e këtyre banorëve, gjendjen e tyre socio-ekonomike, njëkohësisht edhe për fushat tjera, si në Arsim, Shëndetësi, Punësim, Banim ,Infrastrukturë etj.

Ka shumë familje që jetojnë në gjendje jo të mirë ekonomike dhe marin ndihmë sociale, përveç punësimit problem shumë i ndjeshëm te këta ishte edhe kushtet e rënda të banimit, kishe kërkesa për renovimin e shtëpive si në anën e brendshme ashtu edhe të jashtme, po ashtu aty ku nuk ka mundësi ndërtimi të ri kishin kërkesa që të mundësonin mbindërtimin.

1. 1 familje nga komuniteti ashkali jeton në gjendje të rëndë ekonomike me 9 anëtarë të familjes i pa punë ka nevojë për renovim të shtëpisë po ashtu i mban edhe fëmijët e djalit që e ka në vuajtje të dënimit me burg ku kishte problem shëndetësor, fëmijët e kanë moshën nga 3 vjet deri 9 vjet dhe jetojnë me ndihmë sociale
2. 1 familje komuniteti ashkali jeton me 8 anëtarë të familjes, ka 6 fëmijë në shkollë, ka nevojë renovimin e shtëpisë ndërtimin e kulmit
3. 1 familje komuniteti ashkali jeton me 8 anëtarë të familjes, fëmijët i ka prej 5 deri 15 vjet nuk mer ndihmë sociale ka vetëm një pagë të djalit me aftësi të kufizuar, ky mbijeton duke mbledhur hekurishta ka shumë nevojë për renovim të shtëpisë
4. 2 familje të komuniteti ashkali jetojnë në një shëpi të vogël me dy dhoma dhe një banjo, shtëpia e re e ndërtuar ka mundësi t’i vihet edhe një kat i ri pasi qe nuk kanë pronë tjetër, jetojnë me ndihmë sociale , njëra familje ka 6 anëtarë 4 fëmi prej moshës 5 deri 15 vjeq dhe tjetra familje 8 anëtar 6 fëmijë prej moshës 2 deri 12 vjet
5. 1 familje komuniteti ashkali jeton me 4 anëtarë të familjes me dy fëmijë në një hapësirë të ngushtë banimi, rast social ska pronë për ndërtim shtëpie vetëm me mundësinë e mbindërtimit.
6. 1 familje komuniteti ashkali jeton me 11 anëtar të familjës i pa punë edhe vet edhe djemt, në gjendje të rëndë ekonomike jeton me ndihma sociale me bashkësi familjare i kanë 5 fëmijë prej 1 deri 8 vjet.
7. 3 familje komuniteti ashkali jetojnë në bashkësi familjare me 18 anëtar të familjes, me fëmijë të moshës 1 vjet deri 16 vjet kanë shumë nevojë për renovim të shtëpisë

8. 1 familje 2 anëtarë të familjes të moshës 50 vjet jetojnë me një penzion invalidor ka shumë nevojë për renovim të shtëpisë
9. 1 familje jeton në gjendje të rëndë ekonomike kanë shumë nevojë për renovim të shtëpisë në rrugën Skënderbeu jetojnë me ndihma sociale në hapësira shumë të vogla dhe në ambient të pa pastër
10. 2 familje jetojnë në gjendje të rëndë të kushteve ekonomike
11. 1 familje me 3 anëtar të familjes i cili jeton në gjendje të rëndë ekonomike edhe ka nevojë për shërim jashtë shteti

Te Hekurudha në Qytet jeton një familje e komunitetit ashkali me 7 anëtarë

Lagjia e Kuvjatit Balloc jetojnë një familje e komunitetit ashkali me 5 anëtarë

Në Banesa në qytet jetojnë dy familje me 9 anëtarë

-Në Komunën e Podujevës jetojnë dhe banojnë këto komunitete

\*Komuniteti ashkali 152 shtëpi (familje ) me 857 banorë

\*Komuniteti rom 9 shtëpi (familje) me 67 banorë

\*Komuniteti egjiptian 2 shtëpi (familje) me 11 banorë

Gjithsejt janë 163 shtëpi (familje) me 935 banorë

Këto komunitete kanë nevojë edhe për strehim por problemi kryesor qëndron se shumica prej tyre nuk kanë pronë private për të ndërtuar shtëpinë, prej tyre vetëm 3 familje kanë pronë private.

3 familje nuk kanë pronë as shtëpi dhe jetojnë me qira

46 familje kanë nevojë për renovim të shtëpive

2 familje kanë mundësi vetëm të mbi ndërtimit pasi që nuk kanë hapësirë dhe jetojnë në një hapësirë shumë të vogël

Me asistencë sociale jetojnë 66 familje të komunitetit ashkali me 353 anëtarë

5 familje të komunitetit rom me 37 antarë

Gjithsejt janë shfrytëzues të ndihmave sociale 390 antarë

Arsimi

Në SHFMU janë 179 nxënës

10 nxënës janë në sistemin parashkollorë

Në Shkollat e Mesme janë 16 nxënës  
14 nxënës janë në Shkollën e Mesme ISA BOLETINI  
2 nxënës janë në Shkollën e Mesme ALEKSANDËR XHUVANI  
Në kolegje –universitet janë 3 student.

### **Aktivitet:**

#### Trajnim

Veprimi i Komunave për Ri-integrim dhe Diasporës

Trajnimi për implementimin e udhëzuesit për qasjen e të huajve në Aftësimin profesional dhe punësim

#### **Temat:**

- Vlerësimi i nevojave të zyrtarëve
- Qëllimet e trajnimit
  
- E drejta për punësim dhe qasja në tregun e punës
- Akterët kryesor përgjegjës për integrimin Ekonomik të të huajve
- Rregullat e përgjithshme për Integrim në tregun e punës
- Vetëpunësimi
- Diskriminimi dhe Diversiteti
  - Punësimi
  - I të huajve ( personi) pasi të fitojë statusin, shtetësinë e RKS regjistrohet si person i riatdhësuar, të huaj si punëkërkues ku informohen për të drejtat e tyre dhe mundësitë e mbështetjes në MATP ( Masat Aktive të Mesit të Punës).
  - Profilizimi dhe këshillimi i punëkërkuesve të riatdhësuarve apo të huajve për profesionin që kanë për punësim, që kanë të drejtë të konkurojnë me të drejta të barabarta për punësim që i plotësojnë kushtet
  - Vetëpunësimi i të vetëpunësuarve apo të të huajve përmes financimit të planeve të biznesit,
  - Informimi i këtyre personave për mundësitë dhe kushtet e përfitimit nga kjo skemë, prej ZKKK-së, ZP, QAP

- Kur thirrja të jetë e hapur për aplikim ne ju informojmë në kompletimin e dosjes për aplikim
- Aftësimi profesional i personave të riatdhesuar dhe të huajve në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

➤ **PREZENTIM i:**

- Draft: Plani Komunal për Ri-integrimin e Qëndrueshëm të personave të Riatdhesuar për Integrimin e të Huajve në Komunën e Podujevës 2023-2025 .
- Plani është hartuar në bazë të strategjisë për Migrim 2021-2025, Rregulloren ( QRK), Nr.22/2022 për personat Riatdhesuar,si dhe bazuar në Rregulloren për integrimin e të Huajve Rregulloren ( QRK) Nr. 09/2019
- Me qëllim të zbatimit të kordinuar në praktikë të Strategjisë për Integrim 2023-2025
- Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK), në bashkëpunim me Drejtorin Komunal si dhe përfaqësuesit e Organizatave Vendore e Ndërkombëtare qe veprojnë në Komitein Komunal veprues.
- Kanë hartuar Planin Komunal për Ri-integrimin të qëndrueshëm dhe Integrimin e të huajve për Komunën e Podujevës.
- Plani i Veprimit përmban: Objektivat, Aktiitetet konkrete dhe masat për të arritur objektivat, saktëson kornizën kohore për realizmin e Aktiviteteve.
- Në Kordinim me Institucionet Qëndrore dhe Lokale MPB/ Departamenti për Ri-integrimin e personave të Riatdhesuar, për Integrimin e të Huajve DRPRH/MPB-ZKKK, Drejorit përkatës Komunale- KDA-ja, DSHMS, DBF, Zyra për të Drejtat e njeriut dhe Barazisë Gjinore, Qendra për punë Sociale (QPS)
- ZP ( Zyra e Punësimit), OJQ-të Vendore dhe Ndërkombëtare me fokus për Ri-integrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë.
- QAP ( Qendra e aftësimit profesional), ZGJC ( Zyra e Gjendjes Civile)
- ZKKK-ja prezentoj Draft: Planin Komunal për Ri-integrimin e Qëndrueshëm të personave të Riatdhesuar për Inrtegrimin e të huajve në Komunën e Podujevës 2023-2025
- U vlerësua lartë puna dhe aktiviteti Institucional i Komunës së Podujevës.

➤ **Aktivitet:**

**Drafti i Planit të Veprimit për integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2023-2026 në Komunën e Podujevës**

- Pasi ky plan u hartua dhe u punua pas disa takimeve të Grupit punues të Komitetit Komunal Veprues, dhe aktiviteteve në teren në të gjitha lagjet ku jetojnë Komunitetet jo-shumicë dhe ato shkolla ku mësimet vijojnë nxënësit e Komuniteteve jo-shumicë ku kemi diskutuar për rëndësinë e planit.

Draft Plani u diskutua edhe në Komitetin për Komunitetet, Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Kuvendi i Komunës ku është në Diskutim publik me qytetarët.

Pas vendimit për Vënie në Konsultim Publik kemi mbajtur takim me Qytetarë, ku ka pasur edhe diskutime, ZKKK-ja në bashkëpunim dhe koordinim me anëtarët e Komitetit Komunal Veprues dhe zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe informime, do ti marrin në diskutim të gjitha propozimet, sygjërimet apo vërejtjet eventuale gjatë debateve publike, gjithashtu në formë të shkruar mund të paraqiten në e-mail adresën: [liman.zeqiri@rks-gov.net](mailto:liman.zeqiri@rks-gov.net), ku edhe përcillen ne ZKKK brenda periudhës të caktuar kohore.

➤ **Aktivitet:**

- Zkkk-ja: Në mbledhjen e Komitetit për Komunitete në rend dite ishin edhe dy pikat për diskutim, ku i informojë ZKKK-ja .

Draft Plani i Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Podujevës 2023-2026, dhe Draft Plani Komunal për Integrimin e Qëndrueshëm të personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Podujevës 2023-2025.

## **Drafti i Planit të Veprimit për integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2023-2026 në Komunën e Podujevës**

- Propozimi i hartimit të “Planit Komunal për Ri-integrimin e Qëndrueshëm të personave të riadhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Podujevës 2023-2025.
- Pas disa trajnimeve të Organizatave nga MARD-i për Ri-integrimin dhe Diasporë, i cili implementohet nga Caristasi Zvicerian në Kosovë. CACH- në bashkëpunim me Departamentin për Ri-integrimin e personave të riadhesuar dhe integrimin e të huajve (DRPRIH), nga Ministria e Punëve të Brendshme MPB, dhe OJQ-të Ndërkombëtare.
- Në këto trajnime Rajonale, për të gjitha Komunat edhe Komuna e Podujevës, ZKKK-ja, DSHMS,DKA-ja, QPS, ZP, kanë dhënë propozimet, sugjerimet, komentet gjatë debateve për Hartimin e Planit ku janë harmonizuar edhe me diskutime dhe takime të tjera me interes të përbashkët.
- Propozimi i Draft Planit, ka kaluar në Komitetin Komunal për Komunitete, Komitetin për Politikë dhe Financa, dhe Kuvendi i Komunës.
- U mbajt edhe diskutimi publik me qytetarët ZKKK-ja e paraqiti Draft propozimin e Planit të Veprimit ku kishte edhe diskutime, edhe pyetje me interes nga qytetarët për këtë Plan ku edhe u njoftua për Aktivitetet e planit: Ku plani është në diskutim Publik prej datës 22.05.2023 deri më datën 20.06.2023, për propozime, sugjerime apo vërejtje eventuale!
- **Aktivitete;**
- ZKKK-ja kishte një takim pune, ku ne ZKKK-ja kishte një Vizitë Zyrtare me Zyrën për Çështje të Komuniteteve pranë Zyrës së Kryeministrit
- Këshilltarja e Kryeministrit për Komunitete: Elizabeth Gowthing dhe Asistenten e këshilltarës Manuela Petroviç.
- Përpos ZKKK-së në takim ishte edhe Kyesuesi i Komunitetit për Komunitete z. Xhafer Ademi.

- ZKKK-ja i informojë për punën e ZKKK-së dhe Koordinimin e Bashkëpunimin që ZKKK-ja ka me të gjitha Drejtoritë Komunale për Integrimin e Komuniteteve jo-shumicë, ku edhe të gjitha temat me rëndësi, diskutohen edhe Komunitetin për Komunitete, ZKKK-ja i informoj edhe për Hartimin e Veprimit për Integrimin e Planit të Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian për vitin 2023-2026.
- ZKKK-ja i informoj për të gjitha të dhënat për Komunitetet jo-shumicë, si per Arsim, Shëndetësinë, Banim, Strehim, Punësim, Infrastrukturë .
- Gjendja Socio-ekonomike dhe me të gjitha sfidat me të cilat përballen Komunitetet jo-shumicë, sidomos çështja e banimit, punësimit dhe gjendja ekonomike, ku Komuna me të gjitha mundësitë buxhetore qe i ka çdoherë ka ndihmuar këto komunitete dhe ka qenë pranë qytetarëve pa dallime etnike.
- **Aktivitete;**
- ZKKK-ja në Bashkëpunim me Koordinatorin për të Drejtat e Njeriut vizituan 2 familje të Komunitetit Ashkali te Hekurudha afër Emergjencës.
- 1 familje jetojnë me 7 anëtarë të familjes dhe tjetra familje me 5 anëtarë të familjes, jetojnë në gjendje shumë të rëndë të banimit, nuk kanë as pronë dhe asnjë mundësi për ndërtim të shtëpive, mundësisht të shiqohen mundësitë e ndonjë Donatori për strehim dhe banim.

Takim pune në Hotel Emerald në Prishtinë, organizuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ( MAPL), në mbështetje të Projektit për Decentralizim dhe Mbështetje Komunave ( DEMOS) .

### ➤ *U prezentua Draft Raporti*

Vlerësimi i kapaciteteve të strukturave komunale të mandatuara për të dhënat e grupeve të marginalizuara. Në këtë Draft Raport janë mandatuar për të punuar me komunitete jo-shumicë dhe grupe në 24 komuna, ku edhe Komuna jonë i ka dhënë të gjitha të dhënat për hartimin e Draft Raportit, ku edhe u prezentua, pas prezentimit kishte diskutime propozime, sugjerime apo vërejtje eventuale gjatë debateve ku u theksua se këto mund të paraqiten edhe në formë të shkruar ku do të plotësohen për Draft final të Raportit.

Temat ishte edhe roli i kapaciteteve të zyrtarëve komunal për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) .Roli dhe Kapacitetet e Strukturave apo zyrtarëve komunal që merren me barazi gjinore, dhe në të drejtat e njeriut në përgjithësi.

Nga Komuna jonë u prezent në takim ishin Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, SHZKKK-së dhe koordinatori për të drejtat e njeriut ku i paraqitën edhe të gjitha të dhënat e Komunës së Podujevës!

### **- Aktivitete**

- ZKKK-ja Takim me OJQ-në INDEP(Komsioni per Bujqesi ,pylltari,mjedis dhe planifikim hapsinor)

Tema: Punët e renda të femijeve që janë të ndaluara me ligje ,monitorimi dhe paraqitja në Institucione perkatëse.

ZKKK-ja paraqet Veperimetarin dhe angazhimin e Komitetit veprues për parandalimin e punëve të renda për femijet adoleshent. Ku ishim të përfshirë në këto komitet organet përgjegjëse Komunale që merren me këto tema, dhe OJQ-të Vendore dhe nderkombetare. Për vlerësimin ,prej familjeve,institucioneve dhe bizneseve të ndryshme private,që janë të ndaluara punët e renda për femije...

Në këtë tryeze ZKKK-JA paraqiti edhe angazhimet e zyrtarëve të këtij komuniteti me terme dhe takime me qytetarët,për parandalimin e punëve të renda për femijë.

ZKKK-ja më bazë të analizave dhe të dhënave nga tema, shumica e femijeve që punojnë punë të renda ,janë prej asaj shtrese që janë në gjendje jo të mirë materiale.



Sidomos te komunitetit jo-shumicë që përfshihen grupet e marginalizuara që detyrohen që femijet të ngazhohen në punë të rënda, të ndaluara.

Si me Bujqësi me pesticide, në mbledhjen e hekurishteve, kërkojnë lemoshë, ndertimtari etj.

Që të ndalohen, këto veprimtari duhet të angazhohen institucionet përkatëse, inspektoriat i punës dhe organet tjera përhygjese...

#### **-Aktivitete**

ZKKK-ja Takim pune me entin e punsimit, për personat që lajmrohen për punë nga komunitetet jo-shumice ku u informua që mund ndryshon dhe në baze të varianteve dhe statistikave të lajmruar nga komiteti jo-shumicë ishin 26 persona të dy gjinive, që janë të interesuar të gjejnë punë si në sektorin publik ose privat, ku gjdoherë përcjellin informatat dhe janë në kontakt me kompanitë që kërkojnë puntorë si p.sh në ndertimtari, gastronomi dhe bujqësi etj.

Ku koheve të fundit kërkesat për puntorë janë rritur sidomos në sektorin privat që është mungesë e puntoreve, përshkakë të migrimit të shume puntoreve jashtë Vëndit.

#### **-Aktivitete**

- ZKKK-ja duke u bazuar në punët, kordinimin bashkëpunimin me Zyrën pranë Kryeministrit për Komunitetet jo-shumicë, posaqerisht me këshilltarën politike për Komunitete Elizabeth Katherine Goving, ku më herët kemi diskutuar për Komunën tonë, për komunitetet jo-shumicë për themelimin e një Qendre të re komunitare, qendër mësimore, për familjet e cenushmë, veqanërisht familjet nga Komunitetet jo-shumicë Ashkali, Rom dhe Egjiptian, ku ishte edhe vullneti për të mbështetur iniciativën e tillë.

Takim pune:

Kryetari i Komunës me stafin e tij, Drejtorin e DKA-së, Drejtoreshën për SHMS, SHZKKK-së, Kordinatorin për të Drejtat e Njeriut, QPS- Shefen e Kabinetit priti në Takim Drejtoreshën ekzekutive të CONCORDIA që Udhëheqë këtë OJQ-, Mirela Lavriç.

OJQ-ja e cila merret me edukimin dhe mbështetjen e fëmijeve, familjeve të cënueshme, sidomos familjeve të komuniteteve jo-shumicë, për integrimin e mjaftueshëm dhe për një stabilizim për një jetë më të mirë dhe të dinjitetshme.

Drejtoresha Mirela Lavriç e njoftoj Kryetarin për aktivitetet e kësaj shoqate dhe ndihmën që mund të japin për krijimin e kësaj Qendre Mësimore, që do të ndikojë shumë në Socializimin, Integrimin dhe Edukimin Kulturor sportivë, edukativë në te gjitha lëmitë për fëmijët e Komuniteteve jo-shumicë dhe grupet e cënueshme.

Kryetari ofroi mbështetjen e plotë për krijimin e hapsirës për themelimin e kësaj Qendre, për avansimin e mëtutjeshëm për integrimin e sa më të mirë për nxënësit e komuniteteve jo-shumicë, me qëllimin më të mirë për rritjen e mirëqenjes sa më të mirë për familjet e komuniteteve jo-shumicë dhe grupeve të cënueshme..

ZKKK-ja qdoherë është e gatshme për bashkëpunim dhe kordinim më të mirë, me të gjitha Organizatat dhe OJQ-të për të ju dalë në ndihmë të gjithë atyre familjeve që janë në nevojë, grupeve të cënueshme e sidomos familjeve, fëmijëve te komuniteteve jo-shumicë!

### **-Aktivitete**

- Forumi Shumëpalësh të Migrimit në ndëtesën Capital Gate ( Vendodhja e Zyrës së IOM-it ) Prishtinë.

Organizuar nga Organizata Ndërkombëtarë për Migrim IOM, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporë. Fokusi kryesor i këtij forumi ishte marrja e kontributit të palëve të interesuara për hartimin e një kornize të re për angazhimin e Diasporës.

Konferenca kishte për qëllim të sjellë në një vend akterë të dalluar, vendor dhe ndërkombëtarë nga sfera e Migrimit dhe Zhvillimit për të nxitur diskutim dhe shkëmbim të pikëpamjeve mbi trendet aktuale, praktike dhe dhe përvojave më të mira në funksion të nje migrimi që shërben si forcë shtytëse dhe përshpejtuese të zhvillimit Ekonomik.

ZKKK-ja paraprakisht falenderoj Organizatën Ndërkombëtare për Migrim IOM-in për përkrahjen e vazhdueshme që po i jepë Komunës sonë në realizimin e shumë projekteve që kanë për qëllim zhvillimin strategjik të Komunes në Arsim, Ambient, Bujqësi, përkrahje në mjete pune për shumë biznese familjare për vetëpunësim dhe regjenerim të hyrave familjare për stabilizimin Ekonomik për Komunitetet jo-shumicë në Komunën tonë.

Aktivitet:

Takim pune ZKKK-ja në bashkëpunim me OSBE-në për tu informuar prej Entit të Punësimit, për personat që lajmërohen për punë nga komunitetet jo-shumicë ku numri ndryshon në bazë të variacioneve dhe statistikave të lajmëruara nga komunitetet jo-shumicë ishin 33 persona të dy gjinive që janë të interesuar të gjejnë punë në sektorin publik dhe privat.

Po ashtu, edhe për personat e Riatdhesuar ku ne ZKKK-ja iu ndihmojmë për komplotimin e dokumentacioneve që ata të lajmërohen në Entin për Punësim, ku edhe i marrin informacionet në Qendrën e Aftësisit Profesional në Prishtinë, k edhe çertifikohen për drejtimit apo profesionet e tyre, ku postojnë konkurojnë me projekte, ku marrin grante, mjete pune për Vetëpunësim nga organizatat Ndërkombëtare si UNDP-ja ( Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim), URA 2, Aëo Nurnberg, Caritasi, IOM, Gizi, UNHRC-ja etj.

Për një Stabilizim Ekonomik për personat e Riatdhesuar për Ri-integrimin në Shoqërinë Kosovare.

### **-Aktivitete**

- ZKKK- ja takim pune me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)

\* Tema: Rritja e pjesëmarrjes së Komuniteteve jo-shumicë në procesin e përgatitjes së buxhetit komunal

\* Mekanizmat për mbrojtjen e komuniteteve dhe përgatitjen e buxhetit komunal, përgatitja e kornizës ligjore për buxhetin Qershor-Shtator 2023

\* Përgatitja e buxhetit komunal për ZKKK dhe Komitetin për Komunitete

\* Komiteti për Komunitete mund të drejtojë të drejtat e tyre dhe të ketë informata nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, që të informohet për buxhetin komunal për Komunitete dhe për projektet që kanë rëndësi për Komunitetet jo-shumicë.

\* Në bazë të formimit të Grupit Punues për hartimin e planit të punës KK për vitin 2023/24

\* Planifikimi i buxhetit nga Maji deri në Shtator dhe Shtator – Dhjetor.

\* Përveç ZKKK-së, Komitetit për Komunitete, rol të rëndësishëm mund të jep edhe Njësi për të Drejtat e Njeriut, Barazia Gjinore dhe Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi.

\* Në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi pikë e rendit të ditës ishte:

\* Informata dhe diskutimi për projektet (të infrastrukturës dhe shërbimeve) që ndikojnë në sigurinë e qytetarëve që mund të propozohen drejtorive për miratim në Kuvendin Komunal gjatë periudhës së miratimit të buxhetit të Komunës.

\* Kishte propozim edhe nga anëtari i KKSB-së njëherit edhe Kryesuesi i Komitetit për Komunitete nga radhët e Komuniteteve jo-shumicë, paraqiti kërkesën për ndërtimin e rrjetit të ri të ujësjellësit në lagjen “Ali Ajeti” në rrugën Ulqini në qytet ku banojnë dhe jetojnë komunitetet jo-shumicë.

\* ZKKK – ja e informojë OSBE-në se ZKKK-ja në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Kompaninë e Rrjetit të Ujësjellësit Rajonal ka hartuar këtë projekt, ku do të merret parasysh për realizimin e këtij projekti, që është shumë i rëndësishëm për banorët e kësaj lagjeje që të kenë furnizim të mjaftueshëm me ujë të pijes, për një jetë dhe mirëqenie më të mirë për këtë lagje.

\* Pranimi për formimin e komisionit për ankesa në projektin ReLOaD2

\* Si zyrtare kontakuese për deklaram të pasurisë kam kontaktuar me ish zyrtarin Rasim Fejza i cili është i obliguar të deklarojë pasurinë me rastin e pensionimit të tij, pra përfundimin e funksionit.

\* Gjatë javës kemi punuar në komisionin e pranimit të shërbimeve në projektin “Trajtimi i qenve endacak”.

## **-Aktivitete**

\* Duke u bazuar nga MPB përmes MAPL-së që kemi pranuar e-mailet dhe shkresat përkatëse me të cilat konfirmohet ligjshmëria e akteve të miratuara në Kuvendin e Komunës në mbledhjen e datës 31.07.2023.

\* Vendimi për miratimin e Planit Komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Podujevës 2023-2025.

\* Vendimi për miratimin e Planit të Veprimit për integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2023-2026 në Komunën e Podujevës.

\* Duke i vlerësuar lart këto dy Plane të Veprimit nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian OSBE

\* Komuna e Podujevës ka qenë model në hartimin e këtyre planeve në nivel nacional, prandaj OSBE-ja na ka zgjedhë të marrim pjesë dhe të kontribuojmë në hartimin e këtyre dy planeve në Komunën e Ferizajit.

## **-Aktivitete**

\* ZKKK-ja kemi marrë pjesë në këtë punëtori që është mbajtur më 08.09.2023 në Restorantin “Toka” në Komunën e Ferizajit.

\* Në këtë punëtori morëm pjesë akterët që merren me hartimin e këtyre planeve dhe anëtarët e Komitetit Lokal të Veprimit të Komunës së Ferizajit, Gjilanit, Novobërdës dhe Komuna jonë Podujeva, për të dhënë kontributin tonë për hartimin e këtyre planeve.

\* Ku Komuna e Podujevës u vlerësua lart në performancë dhe me kohë për miratimin Planit Komunal për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Podujevës 2023-2025.

\* Dhe Planin e Veprimit për integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2023-2026 në Komunën e Podujevës,  
që u miratuan në Kuvendin e Komunës në mbledhjen e datës 31.07.2023 – Komuna e Podujevës.

### **-Aktivitete**

- \* Takim me zyrtaret komunal për komunitete dhe kthim, Fjalim me Kryeministrin e republikës së Kosovës për të diskutuar për sfidat kryesore të punëve të zyreve komunale për komunitete dhe kthim si dhe munesite për kordinim dhe bashkepunim institucional.

\* Në këtë event u ndanë edhe informacionet rreth fushatës informative të Qeversie për liberalizimin e vizave.

\* Informatat për pengaditjet e regjistrimit të popullatës në republikën e Kosovës që do të fillojnë më 01.11.2023.

\* Prezantimi për punën e inspektoriatit të policisë së Kosovës.

\* Fjalim nga Ministri i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim për procedurat e deritanishme për aplikantët e Komuniteteve jo shumice për renovimin e shtëpive, ndertimin e shtëpive dhe pajisjeve teknike.

\* Punetori per projektet ne bashkepunim me MARDI per planifikimin e projekteve, qe jane bere ne kuaderte Komunes se Podujeves qe ne I kemi bere ne emer te Komunes dhe I kemi prezantuar per implementim. Prejkte kto shume te rendesishme per Komunen tone.

\* Themelim I inkubatorit dhe ndertimi I kompleksit turistik ne liqenin e batllaves.

Ku ZKKK I ka paraqite projektet dhe u vleresua larte dhe prej kordinatorit te projektit MARDI dhe mbetet per tu shqyrtuar dhe per tu implementuar.

#### **-Aktivitete**

-\* ZKKK ja në kordinim dhe bashkëpunim me organizatën ndërkombëtare për migrim IOM, në bazë të memorandumit të bashkëpunimit me Komunën tone që vazhdimisht ka ndihmuar në realizimin e shumë projekteve me rëndësi e sidomos në fushën e edukimit dhe në fushat tjera në Planin e Zhvillimit Ekonomik në Komunën e Podujevës edhe në zhvillimin e bizneseve të vogla me mjete pune për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë, për stabilizim ekonomik për ata persona që merren me zeytari që kanë mundësi për ta rritur biznesin edhe për persona të tjerë .

#### **-Aktivitete**

\* Kështu IOM e ndihmojë me mjete pune Samet Ahmetin pjesëtarë I komunitetit ashkali me rprojektin e mjeteve të punës për çbllokimin e kanalizimeve, mjetet e punës e kishin një kosot me vlerë 4.400€ ku 4000€ ishin prej IOM it dhe 400€ participim. ZKKK-ja

e falenderojë organizatën për bashkëpunim për ti ndihmuar bizneset e vogla për komunitetet jo shumicë për vetë punësim dhe stabilizim ekonomik.

□ Zkkk-ja dhe Dka-ja, takim me OSBE Organizatën Ndërkombëtare për Siguri dhe Bashkëpunim ku u informuam për fillimin e vitit shkollorë 2023/2024 dhe funksionimin e qendrave mësimore për mësim shtesë për nxënësit e komunitetit jo shumicë, ku në dy shkolla janë duke funksionuar në SHFMU “Ibrahim Rugova” dhe në SHFMU “Xheladin Rekalii” në Podujevë.

□ Me ftesën e Zyrës për te Drejtat e Njeriut dhe Zyrës për barazi gjinore kishim diskutim , debat për draft Strategjinë dhe Plani i Veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2023/2026 në Komunën e Podujevës.

□ Në bazë të diskutimeve, prpozimeve, sugjerimeve, komenteve, vërejtjeve që të hartohet Plani i Veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2023/2026, që do të ketë edhe diskutim publik për fazën finale për miratim në Asamblenë Komunale, ZKKK-ja do të japë kontributin e vet.

### **-Aktivitete**

- □ ZKKK-ja takim në Hotel Sirius Prishtinë

Ministria e Punëve të Brendshme-Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve.

Tema: Avancimi i kordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet akterëve të përfshirë në procesin e riintegrimin dhe integrimin të personave të riatdhesuar. Në këtë takim diskutimi është përqëndruar në temat siq janë: Kategorizimi i rasteve të cenushme, verifikimet e rasteve të



personave të riatdhesuar, cilësia e vendimeve dhe kompletimi i lëndëve të akomodimit, përditësimi i anamnezës sociale nga QPS-ja, asistenca shëndetësore, integrimi i të huajve pas përfitimit të azil kërkuesit.

-Vlerësimi i nevojave për personat e riatdhesuar DRPRIH

-Menagjimi i lëndëve dhe cilësia e vendimeve DRPRIH

-Shkëmbimi i praktikave të mira ndërmjet akterëve

-Kordinimi dhe bashkëpunimi ndërmjet akterëve

-Rekomandimet nga ZKKK-ja për punën dhe aktivitetet në teren.

### **-Aktivitete**

□ ZKKK-ja në kuadër të ekipit për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të nxënësve në arsimin e obliguar në Komunën e Podujevës ku ne ishim në SHFMU ‘‘Dëshmorët e Kombit’’ ku u informuam nga drejtori i shkollës për procesin mësimorë, dhe vijueshmërinë e nxënësve në shkollë, ku u informuam se 3 nxënës nuk e vijnë mësimin, një nxënës në klasën e 7-të dhe dy nxënës në klasën e 8-të. Drejtori i shkollës na informoj për të gjitha masat që janë ndërmarrë nga ekipi i shkollës për ti kthyer nxënësit në shkollë dhe për masat e ndërmarra.

Në ekipin që ishim në vizitë ishin zyrtarë nga DKA-ja, QPS-ja, Psikologjia, ZKKK-ja.

Bashkërisht vizituam edhe familjet e nxënësve dhe bashkëbiseduam me prindërit dhe nxënësit për ti kthyer në shkollë dhe për masat që do të merren në aspektin ligjorë për arsimin e obliguar ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të nxënësve.

### **-Aktivitete**

□ ZKKK-ja Takim në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, me zyret për komunitete dhe kthim në nivel rajonal kordinues.

Tema: Për procesin e kthimit, diskutimet rreth këtij procesi, shqyrtimi i kërkesave për ata persona, familje për kthim të qëndrueshëm qoftë kthim i organizuar, vullnetarë ose individual.

Kordinimi dhe bashkëpunimi me MKK, UNHCR dhe ZKKK për procesin e kthimit, krijimi i kushteve për ata persona që dëshirojnë të kthehen në vendin e origjinës.

Informatat dhe vlerësimi në teren për mundësitë për kthim, vizita pronave dhe planet për vitin 2024.

### **-Aktivitete**

- □ ZKKK-ja në koordinim dhe bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare për Migrim – IOM, që vazhdimisht i ka ndihmuar Komunës tone në realizimin e shumë projekteve me rëndësi sidomos në fushën e edukimit dhe në fushat tjera në Planin e Zhvillimit Ekonomik në Komunën e Podujevës, edhe në zhvillimin e bizneseve të vogla me mjete pune për pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë.

\* Komuna kontribuon me 30% në vlerat totale të projektit për bashkëfinancim për implementimin e projekteve me kabinetet e lëndëve shkencore dhe kabinete me vegla muzikore.

\* Komuna çdoherë e ka mbështetë implementimin e projekteve, ku në këto shkolla vijojnë mësimin përveç nxënësve shqiptarë edhe ata të komuniteteve tjera jo-shumicë.

\* Në SHFMU “Zahir Pajaziti” në Orllan

Projekti ka pasë vlerën totale 11.601 €

IOM-I me 8.121 €

Komuna me 3480 €

\* Në SHFMU “Ali Ajeti” në Sfeqël

Projekti ka pasë vlerën totale 14,987.80 €

IOM-I me 10,491.80 €

Komuna me 4,496 €

\* Komuna angazhohet maksimalisht për realizimin e projekteve me mbështetje financiare, dhe është çdoherë falenderuese për Organizatën Ndërkombëtare për Migrim IOM-in.

### **-Aktivitete**

ZKKK-ja në Mbledhjen e Komitetit për Komunitete në Komunën tone, ku në rend të ditës ishte edhe pika me rëndësi për Komunitetet jo-shumicë

\* Informata prej Drejtorisë së Arsimit DKA-së për fillimin e vitit të ri shkollor 2023/24 me theks të veçantë vijueshmëria e nxënësve të komuniteteve jo-shumicë në SHFMU që janë obligative dhe shqetësimet eventuale të tyre për pajisjet me libra mësimore me ciklin e ulët.

\* Problemet e aplikimit për mburësimin financiar mos njohuritë e probleme tjera socio-ekonomike

\* Ku u informuam prej DKA-së për gjendjen e shkollave dhe fillimin e vitit të ri shkollor 2023/24

\* Shqetësime tjera kishte edhe për mos regjistrimin në shkolla prej komuniteteve jo-shumicë ku anëtarja e Komitetit nga radhët e Komunitetit Ashkali paraqiti shqetësimin që në lagjen “Xhafer Meta” 4 nxënës nuk janë regjistruar në shkollë për shkaqe edhe socio-ekonomike, ne ZKKK-ja theksuam që bashkërisht me përfaqësuesit e Komitetit për Komunitete, zyrtarët prej DKA-së që të kontaktojmë me ato familje dhe të kemi informata për gjendjen e tyre që t’i përdorim të gjitha mekanizmat për të regjistruan fëmijën në shkollë.

## **-Aktivitete**

□ Pjesëmarrje në dëgjimin publik të organizuar nga organizata SDK dhe Komuna. Tema e dëgjimit publik ishte “Buxheti gjinor” në të cilën morën pjesë gra të cilat udhëheqin biznese të ndryshme, kultivimi i aronive, përgatitja e ushqimeve tradicionale. Ato paraqitën kërkesat e tyre në këtë takim.

## **-Aktivitete**

- □ ZKKK-ja takim pune me OSBE-në

Pas publikimit të raportit, pasqyra e qendrave mësimore në Kosovë dhe zbatimi I Udhëzimit Administrativ 19/2018 OSBE-ja në kordinim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit MASHTI ishim pjesëmarrës ZKKK-ja paraqiti gjendjen e arsimit në Komunën tonë për Qendrat Mësimore të mësimit shtesë për nxënësit e komuniteteve jo shumicë, dhe funksionimin e tyre për mësim nxënie të nxënësve që kanë nevojë në arsimin e rregullt nga personeli ndihmës tutorë që ndikojnë te nxënësit e komuniteteve jo shumicë për parandalimin dhe mos braktisje të procesit mësimorë që është obligative.

-Në kordinim me DKA-në

ZKKK-ja pas themelimit të ekipit për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të nxënësve në arsimin e obliguar në Komunën e Podujevës.

ZKKK-ja bënë pjesë në grupin punues për hartimin e planit komunal për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të nxënësve në arsimin e obliguar shkollorë.

## **-Aktivitete**

### ZKKK-ja Debat dhe Diskutime

ZKKK-ja në bashkëpunim dhe kordinim me Njësitin për të Drejtat e Njeriut dhe Zyrën për Barazi Gjinore ka organizuar Debate konsultative për Draft Planin Lokal të Veprimit për Barazi dhe Mos Diskriminim në Komunën e Podujevës 2023-2026 ku ka pas komente, rekomandime, sugjerime që do të merren për bazë, për debatin e përgjithshëm publik me qytetarët që do të mbahet me 15.11.2023 në sallën e kuvendit Komuna e Podujevës në ora 11:00.

## **-Aktivitete**

-ZKKK-ja në mbledhjen e komitetit për komunitete në rend dite ishte informata e ZKKK-së për Memorandumin e mirëkuptimit me Organizatën Ndërkombëtare për Migrim IO; për mbështetjen e vazhdueshme për shumë projekte të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të Komunës, dhe për stabilizimin socio-ekonomik për komunitetet jo shumicësi në arsim, kulturë, sport, në mbështetjen e bizneseve të vogla për komunitetet jo shumicë për vetëpunësim me mjete pune për biznes etj.

## **-Aktivitete**

- ZKKK-ja Takimi komunal për zbatimin e politikave për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

Komitete komunale të veprimit dhe nxitja dhe promovimi I punësimit për komunitetet jo shumicë.

Takimi është organizuar nga zyra për qeverisje të mire, Zyra e Kryeministrit në bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushteti Lokal dhe në mbështetje të DEMOS.

Komuna jonë ka themeluar komitetin veprues më 28.02.2023 ku shumë komuna tjera ende se kanë formuar e që komuna e Podujevës u more shembull edhe për miratimit e planit të veprimit për Integrimin dhe Avansimin e të drejtave të Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2023-2026 i cili u potencuaqë deri më tani vetëm tri komuna e kanë miratuar këtë plan veprimi Podujeva, Prishtina dhe Rahoveci dhe u bënë thirrje komunave tjera që sa më pare ta miratojnë këtë plan.

#### **-Aktivitete**

- ZKKK-ja Podujevë i ka përmbushë planet dhe takimet e mbajtura që është antar i komitetit komunal veprues prej 9 anëtarëve ku kordinatorë është Drejtori i DKA-së .

Komiteti Lokal Veprues në bazë të disa takimeve dhe diskutimeve, rekomandimeve, komenteve, sygjerimeve ka arritë ti hartojë3 plane të rëndësishme për zbatimin e politikave për komunitetet jo shumicë .

1.Planin e Veprimit për Integrimin dhe avansimin e të drejtave të komuniteteve rom,ashkali dhe egjiptian 2023-2026.

2.Planin Komunal për Integrimin e Qëndrueshëm të personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Podujevës 2023-2026.

3.Draft Plani Lokal i Veprimit për Barazi dhe Mos Diskriminim në komunën e Podujevës 2023-2026.

## **-Aktivitete**

Komiteti Lokal Veprues në bashkëpunim me Njësitin për të Drejtat e Njeriut dhe ZKKK-në ka mbajtur disa takime edhe diskutime publike , ku Draft Plani është në diskutim deri më 06.12.2023 dhe ne presim komente, rekomandime, sygjerime në mënyrë që ta pasurojmë sa më shumë këtë dokument në finale dhe presim të miratohet nga asambleja komunale.

Komuna e Podujevës ka kordinim të mire me nivelin qendror :Kordinim dhe bashkëpunim me Zyrën e Kryeministrit , me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, me MKK, me MPB dhe me të gjitha Ministrinë tjera që mbështesin komunitetet jo shumicëpër avancimin e të drejtave të tyre po ashtu edhe me OJQ-të vendore dhe Ndërkombëtare sidomos me OSBE-në dhe IOM-in dhe organizata tjera siq është Zëri I Romëve, Ashklive dhe Egjiptianëve e organizata tjera që merren me mbështetje të komuniteteve jo shumicë.

- ZKKK-ja Pas themelimit të Mekanizmit Lokalkundër dhunës në familje dhe fushatës globale 16 ditë aktivizmi prej 25 nëntorit deri më 10 dhjetor e organizuar nga Njësi për të Drejtat e Njeriut dhe e mbështetur nga OSBE-ja 27.11.2023

Hapja e fushatës kundër dhunës në familje kishe edhe debate, sugjerime, komente për parandalimin e dhunës në familje , ku gjatë këtij viti nga zyrtari i policisë u raportua që ishin 77 raste në komunën tone të lajmëruar, dhuna në familje këto raste janë marrë në shqyrtim , kontribut në këtë debat si anëtarë të këtij mekanizmi dhanë , NJDNJ, ZBGJ, Drejtoresha e DSHMS, QPS, Policia e Kosovës, QKMF, DKA, Agjensioni I punësimit , Zyra për ndihmë juridike falas, Zyra për informim, ZKKK, Handikos, etj.

Ky aktivitet është pjesë e fushatës të lansuar nga Ministria e Drejtësisë e përkrahur nga MAPL dhe implemetimi nga Komunitat e Republikës së Kosovës.

## **-Aktivitete**

- Takim pune në Restorant ORA ku në këtë takim ishin present antarët e mekanizmit lokal kundër dhunës në familje në bashkëpunim me OSBE ku udhëheqi edhe ZBGJ.

Kordinatori i NJDNJ dhe ZBGJ e prezantuan këtë fushatë , dalja në teren dhe kontaktet me qytetarë e sidomos me gjininë femërore për vetëdijesimin dhe informimin e rasteve të dhunës në familje ku më shumë është prezente dhuna ndaj grave. U debatuan se shkaqet kryesore që vine deri te dhuna në familje janë gjendja e rëndume socio ekonomike, papunësia, problemet psikike, traumat pas lufte, rrugët deviate mos arsimimi i duhur, problem shëndetësore e shumë faktorë tjerë ku dhuna ma e shprehur është në zonat rurale ku duhet të mbahen edhe takime për vetëdijesimin e qytatave, sensibilizimin sa ma shumë edhe përmes medjave të informimit OJQ ve që meren me këto tema, që sa më pak të ketë dhunë në familje , ku pasojat janë të rënda dhe lënë gjurmë të këqija.

Sa më shumë të ketë debate , kontaktet me qytetarë edhe nëpër SHML që të parandalohet dhuna në familje.

Të kenë informacione për zgjedhjen e problemeve çdo here të jenë funksional Mekanizmi veprues lokal kundër dhunës në familje.

OSBe-ja kishte botuar broshurën me titull Udhëzues për punë efektive të Mekanizmave Kordinues Komunal Kundër Dhunës në Familje MKKDHF I cili do të shërbej për fushatë edhe debate në institucione dhe në teren me qytetarë.

**Me respekt,**

**PODUJEVË**

**Zyra Komonale për Komunitete dhe Kthim**

**Janar 2024**

**SHZKKK – Liman Zeqiri**

---